




Demokracia në Veprim  
Demokratija na Delu  
Democracy in Action

# RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE

---

Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës

**2019**





# **RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE**

Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës

Prishtinë, Kosovë

Dhjetor 2019

Copyright ©2019. Demokracia në Veprim (DnV).

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Prishtinë, Ambasadës Zvicerane në Kosovë, Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorit.

Demokracia në Veprim  
Rruga "Bajram Kelmendi" nr. 45  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 248 038  
[www.demokracianeveprim.org](http://www.demokracianeveprim.org)

# Përmbajtja

<b>Përmbledhje Ekzekutive</b>	<b>4</b>
<b>1. Hyrje</b>	<b>8</b>
<b>2. Metodologjia</b>	<b>9</b>
<b>3. Konteksti Politik</b>	<b>10</b>
<b>4. Korniza Ligjore</b>	<b>12</b>
4.1. <i>Legjislacioni primar dhe sekondar</i>	12
4.2. <i>Sistemi zgjedhor dhe shpërndarja e ulëseve</i>	14
<b>5. Administrimi i zgjedhjeve</b>	<b>15</b>
5.1 <i>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</i>	15
5.2. <i>Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve</i>	19
5.3. <i>Qendra e Numërimit dhe Rezultateve</i>	20
5.4. <i>Certifikimi i listës së votuesve dhe Shërbimi i Votuesve</i>	21
5.5. <i>Regjistrimi dhe certifikimi i kandidatëve</i>	22
5.6. <i>Votimi jashtë vendit</i>	23
<b>6. Fushata Zgjedhore</b>	<b>27</b>
6.1. <i>Shpenzimet e Subjekteve Politike</i>	29
<b>7. Vëzhguesit e Zgjedhjeve</b>	<b>34</b>
<b>8. Dita e zgjedhjeve</b>	<b>35</b>
<b>9. Drejtësia Zgjedhore</b>	<b>40</b>
<b>10. Rekomandimet</b>	<b>44</b>
10.1. <i>Dita e zgjedhjeve dhe kapacitetet e trupave menaxhuese të zgjedhjeve</i>	
10.2. <i>Votimi jashtë vendit</i>	45
10.3. <i>Informimi i votuesve</i>	45
10.4. <i>Fushata</i>	46
10.5. <i>Financimi i subjekteve politike gjatë fushatës</i>	46
10.6. <i>Lista e votuesve</i>	47
10.7. <i>Përfaqësimi gjinor në listat e kandidatëve</i>	47
10.8. <i>Harmonizimi i kornizës ligjore</i>	47
10.9. <i>Drejtësia zgjedhore</i>	47
<b>11. Shtojca</b>	<b>48</b>
11.1. <i>Rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve dhe ndarja e ulëseve sipas subjekteve politike</i>	48



# Lista e Akronimeve

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	Aleanca Kosova e Re
DnV	Demokracia në Veprim
EU-EOM	Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian
FPR	Formulari i Përputhjes së Rezultateve
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KKZ	Komisionet Komunale Zgjedhore
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Këshilli i Vendvotimit
LPV	Lista Përfundimtare e Votuesve
LZP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LVV	Lëvizja Vetëvendosje!
PD	Partia e Drejtësisë
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PSD	Partia Socialdemokrate
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## Përmbledhje Ekzekutive

Dorëheqja e parevokueshme e Kryeministrit të Kosovës Ramush Haradinaj më 19 korrik 2019, i hapi rrugë shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës dhe organizimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Deputetët votuan shpërndarjen e Kuvendit më 22 gusht, ndërsa Presidenti i Kosovës, pasi dekretoi shpërndarjen e Kuvendit, shpalli zgjedhjet për datën 6 tetor. Këto ishin zgjedhjet e katërta nacionale që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës janë zhvilluar në frymë demokratike dhe në përputhje me standardet universale për votim të barabartë, të lirë, të fshehtë dhe të drejtë. Përjashtim nga ky konstatim bëjnë komunat e banuara me shumicë nga komuniteti serb, në të cilat u është bërë presion qytetarëve që të votojnë një subjekt të caktuar politik.

Pavarësisht vlerësimit pozitiv për ecurinë e fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, 88.2% e vendvotimeve i janë nënshtruar procesit të rinumërimit, si rezultat i ankesave të subjekteve politike, kryesisht lidhur me gabimin teknik të Sekretariatit të KQZ-së në formularët e përputhjes së rezultateve. Edhe pse rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotimeve ka evituar mundësitë e kontestimit të rezultateve nga subjektet politike, kjo ka shkaktuar vonesën më të gjatë të certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve që nga viti 2010.

Pranimi i mbi 6 mijë pakove me fletëvotime të supozuara përmes votimit me postë jashtë vendit pas afatit ligjor dhe anulimi i mbi 3 mijë votave të ardhura nga Serbia jashtë procedurës së paraparë ligjore, janë dy nga çështjet më të ndjeshme dhe komplekse të këtyre zgjedhjeve. Vendimet e institucioneve të drejtësisë lidhur me këto dy çështje kanë krijuar praktika të reja për zgjedhjet e ardhshme lidhur me kriteret dhe procedurat që duhet të ndiqen në kuadër të procesit të votimit jashtë vendit.

Fushata zgjedhore në përgjithësi ishte dinjitoze dhe u zhvillua në frymë të qetë dhe konkurruese, me pjesëmarrje të konsiderueshme qytetare. Megjithatë, në komunat me shumicë serbe ku garuan subjektet politike nga ky komunitet, fushata nuk ishte në përputhje me standardet për një garë të lirë dhe të barabartë, pasi që subjektet politike garuese përballë Listës Serbe u intimiduan.

Subjektet politike në pushtet, pa dallim ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, kanë keqpërdorur resurset publike për qëllime të fushatës zgjedhore. Në mbi 10% të aktiviteteve të fushatës të monitoruara nga DnV-ja, është evidentuar keqpërdorimi i veturave zyrtare dhe shërbyesve civil/publik. Fushata është



shoqëruar nga prezenca e organizuar e fëmijëve në tubimet e subjekteve politike, të cilët në disa raste janë parë tekso bartin simbole të subjekteve politike. Pjesëmarrja e grave në aktivitete të fushatës zgjedhore ishte e ulët, qoftë si folëse apo vetëm si pjesëmarrëse.

Monitorimi i shpenzimeve të subjekteve politike nga vëzhguesit e DnV-së ka vënë në pah se tavani i shpenzimeve për fushatën zgjedhore, siç parashihet me ligj, është tejkaluar. Subjektet politike, në 787 aktivitete të monitoruara nga DnV-ja, llogaritet se kanë shpenzuar gjithsej 3,6 milion euro. Në këtë përlogaritje nuk janë përfshirë shpenzimet e aktiviteteve të organizuara para fillimit zyrtar të fushatës dhe aktiviteteve të cilat nuk janë paralajmëruar paraprakisht.

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe pa incidente serioze, ndonëse u evidentuan probleme dhe parregullsi të ngjajshme sikurse në zgjedhjet e kaluara. Rritja e numrit të votuesve me asistencë, pasaktësia e listës së votuesve dhe vështirësitë në gjetjen e qendrës së votimit ishin disa nga parregullsitë dhe problemet kryesore që janë evidentuar nga vëzhguesit e DnV-së në ditën e zgjedhjeve.

Fenomeni i fletëvotimeve të pavlefshme dhe atyre të zbrazëta ka shoqëruar edhe këtë proces zgjedhor. Ndonëse është zvogëluar numri i fletëvotimeve të pavlefshme krahasuar me zgjedhjet e fundit parlamentare, sërish janë evidentuar 33,271 fletëvotime të pavlefshme, prej të cilave 12,374 ishin të zbrazëta. Procesi i rinumërimit ka bërë që rreth 3 mijë nga 35 mijë fletëvotime sa ishin të pavlefshme dhe të zbrazëta fillimisht, të rikualifikohen si të vlefshme, duke zbritur në 3.8 përqindjen e fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta.

Përkundër funksionimit pa përbërje të plotë, si dhe afateve të shkurta kohore, KQZ-ja ka arritur të përmbushë në masë të madhe planin operacional të zgjedhjeve, përjashtuar rastet kur KQZ i është shmangur vendimmarrjes. KQZ-ja dhe Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) kanë qenë transparente lidhur me punën e tyre. Ato kanë njoftuar në vazhdimësi për mbajtjen e takimeve dhe kanë ndarë materialet përkatëse me të gjitha palët e interesit. KQZ-ja ka arritur të adresojë edhe çështjen e identifikimit të votuesve, duke nxjerrë udhëzime që të lejohet identifikimi vetëm me dokumente të lëshuara nga Republika e Kosovës. Sidoqoftë, puna e Sekretariatit të KQZ-së nuk ka kaluar pa gabime. Si rezultat i një lëshimi në Formularin e Përputhjes së Rezultateve, në të gjitha vendvotimet ishin shpërndarë formularë të gabuar, e cila ndikoi në çuarjen në rinumërim të pothuajse të gjitha vendvotimeve në nivel vendi.

Puna në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ka qenë transparente, ndërsa procesi i rinumërimit në përgjithësi ka ndikuar në rritjen e integritetit zgjedhor, duke evituar të gjitha parregullsitë e evidentuara gjatë pranimit të materialeve apo pas vendimeve për rinumërim nga PZAP-ja. QNR-ja, përpos numërimit të votave me kusht dhe votave të dërguara me postë nga jashtë vendit, ka rinumëruar gjithsej 2,247 kuti të votimit, prej 2,547 kutive sa kanë qenë gjithsej në tërë Kosovën.

Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre ka rrjedhur normalisht dhe nuk janë shfaqur ankesa nga asnjë palë lidhur me këtë proces. Të gjitha 25 subjektet politike janë certifikuar nga KQZ. Subjektet politike kanë respektuar vetëm kriterin minimal të përfshirjes së grave në lista, me vetëm 343 gra, apo 32%, nga gjithsej 1,067 kandidatë.

Renditja e subjekteve politike në fletëvotim është vendosur të jetë nga numri 111 e tutje, duke evituar kështu mundësinë që kandidati dhe subjekti politik të kenë numrin e njëjtë. Kjo çështje ishte ngritur në vazhdimësi nga DnV-ja pasi ishte vlerësuar se kjo mund të favorizonte kandidatë të caktuar dhe të prodhonte garë të pabarabartë ndërmjet kandidatëve brenda listës së njëjtë.

Procesi zgjedhor është administruar mbi bazën e kornizës së njëjtë ligjore, me ndryshime minimale, përkundër tentimeve të kohëpaskohshme për reformë zgjedhore. Reforma e rinisur gjatë këtij viti nga Komisioni ad-hoc për Forcimin dhe Përmirësimin e Procesit Zgjedhor për t'i adresuar mangësitë teknike në administrimin e zgjedhjeve, ishte ndërprerë si rezultat i shpërndarjes së Kuvendit. Ndryshimi kryesor normativ në këto zgjedhje ishte ndryshimi i Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2013, në funksion të qartësimin të dispozitave që rregullojnë pjesëmarrjen e shërbyesve civil dhe atyre publik, si dhe fëmijëve në aktivitetet e fushatës zgjedhore.<sup>1</sup> Ky ndryshim ishte bërë dy ditë pas fillimit të fushatës zgjedhore. Ndërsa, me vendimet e Gjykatës Supreme lidhur me fletëvotimet e ardhura me vonesë nga jashtë vendit, praktikisht janë shfuqizuar dispozitat ligjore të LPZ dhe Rregullës Zgjedhore për Votim Jashtë Vendit, të cilat parashohin që paket me fletëvotime të supozuara duhet të mbërrijnë në fahun postar të KQZ-së të paktën 24 orë para ditës së zgjedhjeve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, si institucion përgjegjës për garantimin e drejtësisë zgjedhore, ka vepruar me profesionalizëm të lartë dhe në mënyrë të paanshme në trajtimin e ankesave dhe apeleve të subjekteve

---

<sup>1</sup> Për më shumë, shih Rregullën Nr. 20/2019, për Plotësim-Ndryshimin e Rregullës së KQZ-së, Nr. 13/2013. E qasshme në: <http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Rregullore-zgjedhore-nr-20-2019-per-Ndryshim-Plotesim-te-Rregulles-se-KOZ-numer-13-2013-1.pdf>

politike dhe kandidatëve, duke respektuar afatet kohore. Që nga shpallja e zgjedhjeve, PZAP-ja ka pranuar 514 ankesa dhe apele.

Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve u shpallën më 7 nëntor, gjegjësisht 32 ditë pas ditës së zgjedhjeve. Ndërsa, këto rezultate u certifikuan më 27 nëntor, apo 53 ditë pas ditës së zgjedhjeve, që njëherësh është periudha më e gjatë kohore e cila i është dashur KQZ-së për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve.

# 1. Hyrje

Ky raport paraqet vlerësimin e procesit zgjedhor në tërësi, duke përfshirë përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve nga institucionet përkatëse, fushatën zgjedhore, ditën zgjedhjeve dhe proceset e numërimit dhe rinumërimit që janë zhvilluar në QNR. Të gjeturat bazohen në monitorimin e realizuar nga vëzhguesit e Demokracisë për Veprim (DnV), si dhe informacioneve zyrtare të marra nga institucionet përkatëse zgjedhore, duke përfshirë KQZ-në, PZAP-në dhe të tjera.

DnV-ja është rrjet i organizatave jo-qeveritare në Kosovë që promovon zgjedhje të lira dhe të drejta përmes monitorimit të procesit zgjedhor, edukimit të votuesve dhe avokimit për reformë zgjedhore. DnV-ja ka vëzhguar zgjedhjet e parakohshme parlamentare për Kuvendin e Kosovës të mbajtura më 6 tetor 2019. Misioni i vëzhgimit është përbërë nga 72 vëzhgues afatgjatë (LTO) të cilët kanë vëzhguar fushatën zgjedhore dhe janë angazhuar në ditën e zgjedhjeve, dhe 2,700 vëzhgues afatshkurtër (STO) të cilët u angazhuan në ditën e zgjedhjeve. Vëzhguesit e DnV-së kanë mbuluar të gjitha 38 komunat e Kosovës si dhe të gjitha vendvotimet.

Në ditën e zgjedhjeve, DnV-ja ka angazhuar edhe 100 ekipe mobile të cilat u përkujdesën për aspektet logjistike të misionit të vëzhgimit, dhe 150 vullnetarë të cilët kanë qenë të stacionuar në Qendrën e Thirrjeve në Prishtinë për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat e dërguara nga vëzhguesit në terren. Pas ditës së zgjedhjeve, DnV-ja ka vëzhguar procedurat tjera dhe aktivitetet e QNR-së.

## 2. Metodologjia

DnV-ja ka vëzhguar në mënyrë sistematike punën e trupave përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, duke përfshirë KQZ-në, KKZ-të dhe PZAP-në. Më tutje, DnV-ja ka vëzhguar edhe fushatën zgjedhore, për vëzhgimin e së cilës është përdorur kryesisht metoda primare e hulumtimit me vëzhgues në terren. Vëzhguesit kanë qenë të angazhuar në mbledhjen e të dhënave për informatat si vijon:

- › Përfaqësimi i grave në fushatë dhe tubime politike;
- › Pjesëmarrja dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara;
- › Përfshirja e fëmijëve në fushatë politike;
- › Shfrytëzimi i resurseve publike;
- › Përdorimi i gjuhës së urrejtjes;
- › Shpenzimet gjatë fushatës zgjedhore.

Në ditën e zgjedhjeve vëzhguesit kanë raportuar në pesë intervale të ndryshme kohore lidhur me ecurinë dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve, parregullsitë apo incidentet e evidentuara, pjesëmarrjen në zgjedhje si dhe rezultatet e subjekteve politike. Të dhënat e marra nga terreni janë përpunuar dhe analizuar në Qendrën e Thirrjeve të DnV-së. Këto të dhëna janë procesuar dhe analizuar nga një ekip personash të specializuar në fushat përkatëse, të cilat pastaj janë përgatitur njoftimet për publikun.

Pas ditës së zgjedhjeve, DnV-ja ka vëzhguar edhe punën e QNR-së, përkatësisht procesimin e të dhënave nga vendvotimet, proceset e rinumërimit, si dhe procesimin dhe numërimin e votave me kusht dhe atyre të ardhura nga jashtë vendit. Po ashtu, sa i përket kontesteve zgjedhore, DnV-ja ka përcjellë trajtimin e apeleve dhe ankesave në PZAP dhe në Gjykatën Supreme.

Për hulumtimin e shpenzimeve të subjekteve politike është angazhuar një ekip prej dhjetë personave, të cilët kanë hulumtuar çmimet e artikujve të ndryshëm të cilat figurojnë në formularin e vëzhguesve të përpiluar nga DnV-ja. Ekipi ka qenë i angazhuar në gjetjen e informatave mbi çmimet e artikujve të cilat janë përdorur gjatë fushatës zgjedhore. Çmimet janë mbledhur nga së paku tre ofrues të artikujve specifik. Në kalkulim nuk përfshihen zbritjet e mundshme të çmimeve që mund të aplikohen nga operatorët ekonomik që kontraktohen nga subjektet politike gjatë aktiviteteve të tyre. Për monitorimin e reklamimit nga subjektet politike gjatë fushatës zgjedhore, ekipi për hulumtim të tregut ka kontaktuar me medime të njohura që operojnë në Kosovë (TV, portale, gazeta, radio), duke mbledhur kështu çmimet për lloje të ndryshme reklamimi nga një numër medimesh të ndryshme. Nga medimet të cilat kanë pranuar të ndajnë

çmimet e tyre për hapësirat e reklamimit, janë mbledhur çmimet minimale dhe maksimale të reklamimit.

Gjithashtu, gjatë fushatës zgjedhore, DnV-ja ka monitoruar televizionet (kronikat zgjedhore dhe spotet reklamuese), transmetimet direkte nga portalet, faqet zyrtare të partive politike dhe faqet zyrtare të kandidatëve për postin e kryeministrit, në rrjetin social Facebook. Të dhënat e detajuara gjatë fushatës zgjedhore do të përmbliidhen dhe publikohen në një raport të veçantë. Monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore është bërë në baza ditore, në intervalin kohor 17:00-24:00.

### 3. Konteksti Politik

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Republika e Kosovës ka pasur katër qeveri me tre kryeministra të ndryshëm. Asnjë qeveri nuk ka arritur ta përfundojë mandatin e plotë katër-vjeçar.<sup>2</sup> Më 19 korrik 2019, Kryeministri Ramush Haradinaj dha dorëheqje të përvokueshme nga posti i tij pasi kishte pranuar një ftesë nga Gjykata Speciale në cilësinë e të dyshuarit.<sup>3</sup> Haradinaj kishte deklaruar pas aktit të dorëheqjes se ai kishte vendosur të shkonte në intervistë si një qytetar i thjeshtë dhe jo si kreu i Qeverisë së Kosovës.

Pas dorëheqjes së Kryeministrit Haradinaj, më 2 gusht, në përputhje me nenin 95 të Kushtetutës, Presidenti Thaçi i kërkoi zyrtarisht liderit të koalicionit fitues nga zgjedhjet e fundit, Kadri Veseli, të propozojë mandatarin e ri për formimin e Qeverisë së re. Në një përgjigje të menjëhershme, Veseli informoi Presidentin Thaçi se koalicioni PAN nuk do të propozonte një mandatar të ri.

Kryesia e Kuvendit thirri seancë plenare më 22 gusht, në të cilën ishte vendosur si pikë e rendit të ditës kërkesa e grupit të deputetëve për shpërndarjen e Kuvendit. Në këtë seancë, deputetët e Kuvendit të Kosovës vendosën në favor të shpërndarjes së Legjislaturës së Gjashtë. Të pranishëm në sallë ishin gjithsej 92 deputetë, prej të cilëve 89 votuan për, një kundër dhe dy abstenuan<sup>4</sup>. Më 26

---

<sup>2</sup> Arta Sopi, "Kosova, shteti ku asnjë kryeministër nuk e përfundoi mandatin e plotë," *Kallxo.com*, 19 korrik 2019, <https://kallxo.com/gjate/analize/kosova-shteti-ku-asnje-kryeminister-nuk-e-perfundoi-mandatin-e-plote/>

<sup>3</sup> Zijadin Gashi, "Haradinaj jep dorëheqje, ftohet nga Gjykata Speciale," *Radio Evropa e Lirë*, 19 korrik 2019, <https://www.evropaelire.org/a/haradinaj-jep-doreheqje/30065096.html>

<sup>4</sup> Për më shumë, shih votimin: <http://votaime.org/Public/PlenarySessions/ViewVotingActivity/824>

gusht, Presidenti i vendit Hashim Thaçi, nënshkroi dekretin për shpalljen e datës së zgjedhjeve, të cilat u caktuan të mbahen më 6 tetor.<sup>5</sup>

Votimi për shpërndarjen e Kuvendit pushoi edhe aktivitetin e legjislaturës së gjashtë. Kjo legjislaturë u karakterizua me probleme të shumta në funksionimin e rregullt të jetës parlamentare. Koalicioni qeverisës ishte trazuar sidomos pasi Qeveria e Kosovës vendosi tarifën 100% për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnje dhe Hercegovina në nëntor të vitit 2018. Taksa kishte kontribuar në pezullimin e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, meqë kjo e fundit kishte refuzuar pjesëmarrjen në dialog deri në heqjen e tarifës. Përkundër thirrjeve të shteteve të *Quint*-it për të hequr tarifën, Haradinaj nuk ndryshoi pozicion. Përçarjet brenda koalicionit qeverisës vazhduan të thelloheshin pasi që Kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe drejtuesi i PDK-së, Kadri Veseli, kishte propozuar një pezullim të përkohshëm të tarifës, e cila u kundërshtua fuqishëm nga Kryeministri Haradinaj. Kjo situatë përshkallëzoi edhe më tepër raportet mes partnerëve të koalicionit, të cilët filluan edhe publikisht të kundërshtonin njëri-tjetrin rreth tarifës dhe çështjeve që kryesisht kishin të bëjnë me dialogun Kosovë-Serbi dhe raportet me bashkësinë ndërkombëtare.

Zgjedhjet e parakohshme të vitit 2019 përsëri u organizuan pa përfundimin e reformës zgjedhore. Komisioni *ad-hoc* parlamentar i krijuar për të trajtuar aspektet teknike të zgjedhjeve nuk ka arritur japë rezultatet e parapara, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit. Për më tepër, procesi i reformës zgjedhore është konsideruar si një nga dështimet kryesore të të gjitha legjislaturave që nga viti 2011 dhe i atribuohet mungesës së vullnetit të partive politike dhe zgjedhjeve të parakohshme.

---

<sup>5</sup> Koha.net, "Zyrtare zgjedhjet më 06 tetor," 26 gusht 2019, <https://www.koha.net/arberi/180957/thaci-vendos-zgjedhjet-me-6-tetor/>

## 4. Korniza Ligjore

### 4.1. Legjislacioni primar dhe sekondar

Korniza ligjore për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës përbëhet nga këto dokumente kyçe të legjislacionit: Kushtetuta e Kosovës, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji për Financimin e Subjekteve Politike dhe Kodi Penal i Kosovës. Në kuadër të legjislacionit sekondar, përfshihet Rregullorja e Punës së KQZ-së dhe Rregullorja e Punës së PZAP-së, si dhe 19 rregulla zgjedhore të nxjerra nga KQZ.

*Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LPZ)* në Republikën e Kosovës përcakton sistemin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin, mbrojtjen e të drejtës për të votuar, kriteret për pranueshmërinë e votës, mirëmbajtja e listës së votuesve, regjistrimin dhe certifikimin e subjekteve politike, përgjegjësitë dhe funksionimin e KQZ-së, organizimin dhe funksionimin e komisioneve komunale zgjedhore dhe këshillave të vendotimeve, rregullat për akreditimin e vëzhguesve, kufizimet e shpenzimeve për fushatë dhe obligimet për publikim financiar, mbulimin e fushatës zgjedhore nga mediat, Kodin e mirësjelljes të subjekteve politike, kandidatëve dhe mbështetësve, procedurat e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve, si dhe aspekte tjera lidhur me procesin zgjedhor në Kosovë.<sup>6</sup>

*Ligji për Financimin e Subjekteve Politike* rregullon administrimin, shpenzimet, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin financiar të subjekteve politike para, gjatë dhe pas fushatës zgjedhore.<sup>7</sup> Më konkretisht, përmes këtij ligji specifikohen në detaje çështjet financiare dhe shpenzimeve të subjekteve politike, përfshirë këtu edhe kohën e zgjedhjeve. Ndër specifikat kryesore të këtij ligji janë rregullimi i aspekteve rreth statusit të subjektit politik, burimet financiare dhe materiale të subjekteve, forma e kontributeve për subjektet politike, fondi për mbështetjen e subjekteve politike që alokohet nga buxheti i shtetit dhe të ngjajshme. Në veçanti, ky ligj rregullon edhe ndarjen e mjeteve financiare për fushatat zgjedhore. Sipas nenit 10 të këtij ligji, për financimin e fushatës zgjedhore qendrore dhe lokale, për zgjedhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme, Kuvendi mund të ndajë mjete nga fondi me propozim të Qeverisë por jo më shumë se 0.05% të buxhetit të Kosovës. Mjetet për financimin e fushatës zgjedhore ndahen për subjektet politike të cilat marrin

---

<sup>6</sup> Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, *Gazeta Zyrtare*, 15 qershor 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

<sup>7</sup> Ligji Nr. 03/L-074 për Financimin e Subjekteve Politike në Republikën e Kosovës, *Gazeta Zyrtare*, 21 tetor 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>



pjesë në zgjedhje ku 90% e mjeteve financiare ndahen në bazë të numrit të vendeve në Kuvend, kurse 10% e mjeteve financiare ndahen proporcionalisht për subjektet politike të posa regjistruara dhe të certifikuara për zgjedhjet nga KQZ-ja.

*Kodi Penal* i Republikës së Kosovës në 11 nene të saj përcakton të gjitha veprat penale kundrejt procesit zgjedhor.<sup>8</sup> Disa nga veprat penale që sanksionohen me Kodin Penal janë: ndalimi ose pengimi i personit nga kandidimi në zgjedhje, pengimi i kandidatit nga aktivitetet e fushatës, pengimi i votuesit gjatë votimit ose ndikimi në vendim, ndërmjetësimi i ryshfetit për favor të votave, votimi ose tentativa për të votuar në emër të dikujt tjetër, shpërdorimi i detyrës zyrtare të stafit zgjedhor, votimi i dyfishtë, pengimi ose ndalimi i paligjshëm i procesit të votimit, shkelja e privatësisë në votim, falsifikimi i rezultateve, dëmtimi i dokumenteve të votimit dhe të tjera.

*Legjislacioni sekondar*, i cili zgjeron parimet e përfshira në ligjet që rregullojnë zgjedhjet, është miratuar nga KQZ-ja përmes rregullave zgjedhore me anë të së cilave rregullohen aspekte të caktuara të procesit zgjedhor. Gjithsej, KQZ-ja ka nxjerrë 19 rregulla zgjedhore.

Për zgjedhjet e 6 tetorit, korniza ligjore ka pësuar ndryshime të vogla, që ndërlidhen kryesisht me aspektin teknik të organizimit, administrimit dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor. Pas shpalljes së zgjedhjeve, KQZ miratoi një udhëzim për KKZ-të dhe KVV-të lidhur me identifikimin e votuesve në vendvotime. Ky udhëzim kishte qartësuar dispozitat ligjore lidhur me dokumentet e vlefshme të cilat mund të përdoren për identifikimin e votuesve. Ky udhëzim obligonte trupat përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve që të pranojnë si të vlefshme vetëm dokumentet e lëshuara nga institucionet e Republikës së Kosovës, të parapara me nenin 90 të LPZ. Kundër këtij vendimi kishte votuar dhe reaguar anëtari i KQZ-së nga radhët e Listës Serbe. Ky subjekt politik kishte apeluar këtë vendim në PZAP. Pas refuzimit të këtij apeli nga ana e PZAP-së, Lista Serbe kishte dërguar këtë çështje edhe në Gjykatën Supreme, e cila kishte rrëzuar përfundimisht pretendimet për anulimin e këtij udhëzimi. Si rezultat i këtij udhëzimi, anëtari nga radhët e Listës Serbe kishte refuzuar pjesëmarrjen në mbledhjet e KQZ-së për disa mbledhje me radhë. Në fakt, me anë të këtij vendimi, ishte adresuar një nga parregullsitë më të shpeshta që ka shoqëruar proceset zgjedhore në Kosovë, identifikimi i

---

<sup>8</sup> Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, *Gazeta Zyrtare*, 14 janar 2019, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>

votuesve me dokumente të cilat nuk janë lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Ndryshim tjetër në kornizën ligjore, respektivisht atë sekondare, ishte edhe ai i Rregullës Zgjedhore për Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike. Me anë të rregullës së re, e cila ishte miratuar më 26 shtator 2019, ishin qartësuar dispozitat të cilat rregullojnë pjesëmarrjen e fëmijëve dhe shërbyesve publik në fushatë. Ky ndryshim i rregullës zgjedhore ishte bërë dy ditë pas fillimit të fushatës zgjedhore, duke ndryshuar kështu rregullat në mes të garës, që është në kundërshtim me praktikën e mira të zgjedhjeve të parapara nga Komisioni i Venecias, të cilat parashohin që ndryshimet duhet të bëhen gjashtë muaj deri në 12 muaj para ditës së zgjedhjeve.

Në këtë proces zgjedhor, si rezultat i vendimeve të Gjykatës Supreme lidhur me votat e pranuar me vonesë në kuadër të operacionit të votimit jashtë vendit, është ndryshuar korniza ligjore e zgjedhjeve, që rregullon këtë operacion. Në vendimet e Gjykatës Supreme, të cilat ishin bazuar në interpretim të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ishte konstatuar që ka mospërputhje mes neneve të LPZ dhe protokollit në fjalë. Si rrjedhojë, dispozitat e LPZ dhe rregullës përkatëse zgjedhore, që precizojnë se pakot me fletëvotime duhet të arrijnë në fahun postar të KQZ-së 24 orë para ditës së zgjedhjeve, praktikisht ishin shfuqizuar.

## **4.2. Sistemi zgjedhor dhe shpërndarja e ulëseve**

Sistemi zgjedhor përcaktohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila garanton lirinë e asociimit dhe të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, si dhe nga kapitulli 18 i *Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme*. Kosova operon në një zonë të vetme zgjedhore dhe aplikon sistem zgjedhor proporcional me listë të hapur, në të cilën votohen një subjekt politik dhe deri në pesë kandidatë nga po i njëjti subjekt politik.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka gjithsej 120 deputetë, prej të cilëve 20 vende janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Partitë politike, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, kanë numrin e vendeve të fituara në zgjedhje, me minimum 10 vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë. Ndërsa sipas logjikës së njëjtë, 10 vende të tjera janë të garantuara për komunitetet tjera, duke përfshirë nga një vend për komunitetin ashkali, egjiptian dhe rom, si dhe një vend shtesë i takon njërit prej këtyre komuniteteve që fiton numrin më të madh të votave të përgjithshme. Për komunitetin

boshnjak janë të garantuara tre vende, për komunitetin turk dy dhe për komunitetin goran një.<sup>9</sup>

Pragu zgjedhor prej 5% aplikohet për partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e pavarur për të pasur të drejtën për përfaqësim në Kuvend. Ndërsa subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë nuk i nënshtrohen pragut zgjedhor. Gjithashtu, në Kosovë aplikohet edhe kuota gjinore. Në LPZ përcaktohet që në listat e kandidatëve të secilit subjekt politik duhet të jenë së paku 30% kandidatë të gjinisë më pak të përfaqësuar. I njëjti kriter aplikohet edhe sa i përket shpërndarjes së vendeve në Kuvend, ku duhet të jenë së paku 30% nga gjinia më pak e përfaqësuar. Deputetët zgjidhen për mandat katër vjeçar.

## 5. Administrimi i zgjedhjeve

Bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi, organi përgjegjës për përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha veprimeve që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, si dhe shpalljen e rezultateve të tyre, është KQZ. Në kryerjen e përgjegjësisë dhe funksioneve të tij, ky institucion kushtetues ndihmohet nga Sekretariati i KQZ-së.

Me qëllim të përgatitjes dhe administrimit të zgjedhjeve në mënyrë sa më efikase, në nivele komunale janë themeluar Komisionet Komunale Zgjedhore, të cilat funksionojnë në bazë të *Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme*. Këto komisione janë të themeluara në secilën prej 38 komunave të Kosovës.

Trupat përgjegjëse për administrimin e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve janë Këshillat e Vendvotimeve, të cilat përbëhen nga pesë deri në shtatë anëtarë. Ndërsa pas përfundimit të ditës së zgjedhjeve, lokacioni ku zhvillohet procesi i numërimit të votave me kusht, votave nga jashtë, si dhe proceseve eventuale të rinumërimit është Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, e cila vepron sipas vendimeve të KQZ-së.

### 5.1 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Pas votimit për shpërndarjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës më 22 gusht 2019, Presidenti Hashim Thaçi morri vendim që zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbahen më 6 tetor 2019, duke i dhënë

---

<sup>9</sup> Kushtetua e Republikës së Kosovës, Neni 64: Struktura e Kuvendit, [http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se\\_.Kosoves-2.pdf](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves-2.pdf)

KQZ-së si institucion përgjegjës një afat kohor prej 40 ditësh për organizimin dhe administrimin e tyre.

Përgjatë periudhës së zgjedhjeve, KQZ-ja ka funksionuar pa përbërjen e saj të plotë, respektivisht me 10 anëtarë, si rezultat i mos propozimit të një anëtari tjetër nga ana koalicionit PAN. Kjo mungesë, e shoqëruar me bojkotimin e pjesshëm të mbledhjeve të KQZ-së nga ana e anëtarit nga radhët e Listës Serbe, si dhe periudha deri në zëvendësimin e njërit nga anëtarët nga radhët e LDK-së, ka rrezikuar vendimmarrjen në KQZ. Përkundër funksionimit pa përbërje të plotë si dhe afateve të shkurta kohore, KQZ ka arritur të përbushë në masë të madhe planin operacional të zgjedhjeve.

Sidoqoftë, puna e Sekretariatit nuk ka kaluar pa gabime. Si rezultat i një lëshimi në Formularin e Përputhjes së Rezultateve, që nuk ishte evidentuar me kohë, në të gjitha vendvotimet ishin shpërndarë formularë të gabuar, e cila ndikoi në çuarjen në rinumërim e pothuajse të gjitha vendvotimeve në nivel vendi.

Fryma e bashkëpunimit mes anëtarëve të KQZ-së është cenuar në disa raste, që ndërlidhen me vendimin lidhur me dokumentet e vlefshme të identifikimit, përbërjen e KKZ-ve dhe KVV-ve, operacionin e votimit jashtë vendit dhe të ngjajshme. Pothuajse të gjitha mbledhjet e mbajtura nga KQZ-ja kanë qenë të paralajmëruara për publikun, si dhe janë ofruar pjesa më e madhe e dokumenteve apo materialeve të miratuara. Në këtë drejtim, KQZ-ja ka shënuar progres të ndjeshëm sa i përket transparencës dhe bashkëpunimit me palët e interesit, sidomos me organizatat vendore të shoqërisë civile.

Bazuar në dispozitat ligjore, KQZ-ja filloi përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve menjëherë pas shpalljes së tyre nga ana e presidentit, duke mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme ku u caktuan afatet kryesore për aktivitetet që janë të ndërlidhura me procesin zgjedhor.<sup>10</sup> Disa prej këtyre afateve ishin ndryshuar, kryesisht si rezultat i garantimit të mbarëvajtjes së rregullt të procesit, apo edhe pamundësisë për t'i përmyllur ato në kohë. Po ashtu, si rezultat i natyrës së parakohshme të zgjedhjeve, KQZ-ja kishte marrë vendim për shkurtrimin e afateve për disa aktivitete zgjedhore. KQZ-ja intensifikoi mbledhjet e saj gjatë periudhës prej ditës së shpalljes së zgjedhjeve e deri në ditën e mbajtjes së tyre.

---

<sup>10</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Vendim për Caktimin e Afateve të Aktiviteteve Zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme," 27 gusht 2019, [http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/824-2019-Vendim-per-caktimin-e-afateve-te-aktiviteteve-zgjedhore\\_27-08-2019\\_0394\\_2-1.pdf](http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/824-2019-Vendim-per-caktimin-e-afateve-te-aktiviteteve-zgjedhore_27-08-2019_0394_2-1.pdf)

Gjatë fazës së parë të përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve, KQZ-ja u ballafaqua me sfida në aspektin e sigurimit të mjeteve financiare për operacionet e parapara zgjedhore. Ndonëse KQZ-ja kishte miratuar buxhetin prej 5,698,486 Euro për organizim të zgjedhjeve, që kishte shënuar rritje të lehtë me proceset e kaluara, alokimi i tyre u bë me një javë vonesë për shkak të paqartësisë lidhur me kompetencat e kabinetit qeveritar pas dorëheqjes së kryeministrit.

Shuma maksimale për shpenzimet e fushatës nga subjektet politike ishte 986,233 Euro, apo 0.50 cent për votues të regjistruar. Numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar sipas listës preliminare të Regjistrimit Civil të Republikës së Kosovës, ishte 1,972,466 votues.<sup>11</sup>

Ngjashëm sikur në proceset paraprake zgjedhore, në funksion të garantimit të integritetit të zgjedhjeve në katër komunat veriore, KQZ-ja kishte marrë vendim për përfshirjen e misionit të OSBE-së, me rol të kufizuar në ofrimin e këshillave për Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillave të Vendvotimit në këto katër komuna.

KQZ kishte miratuar edhe dizajnin e fletëvotimit dhe dizajnin e broshurës së kandidatëve, të cilat vizuelisht ishin të njëjta me dizajnin e zgjedhjeve të kaluara, përkundër që ndryshimi i dizajnit të fletëvotimit ka qenë rekomandim i kamotshëm i shoqërisë civile. KQZ-ja nuk kishte pranuar dizajnin e propozuar nga Instituti i Kosovës për Demokraci (KDI), i cili ishte testuar edhe me qytetarë dhe kishte prodhuar numër shumë më të vogël të fletëvotimeve të pavlefshme. KQZ-ja ka shtypur 1,817,200 fletëvotime apo 7% më pak se numri i votuesve të regjistruar. Po ashtu, për këto zgjedhje është miratuar edhe një formular i ri për paraqitjen e rezultateve preliminare të subjekteve politike. Ky formular nuk është dokument zyrtar, mirëpo përdorimi i tij është i limituar vetëm në funksion të paraqitjes më të shpejtë të të dhënave për rezultatet e subjekteve politike.

Informimi dhe edukimi i votueseve nga KQZ u bë me vonesë, pasi tenderi përkatës fillimisht ishte anuluar. Kontrata për fushatën e informimit, vlera e së cilës ishte mbi 210 mijë euro, ishte dhënë më 19 shtator, duke lënë kështu një periudhë prej vetëm dy javësh për implementimin e Strategjisë së KQZ-së për informim publik. Ndër të tjera, KQZ-ja kishte marrë vendim për miratimin e sloganit të këtyre zgjedhjeve “Votojmë për të ardhmen tonë!”. Megjithatë, ky slogan ishte ndryshuar për shkak të ngjashmërisë me sloganin e një prej

---

<sup>11</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, “Vendim për Kufizimin e Shpenzimeve të Fushatës për Subjektet Politike,” 31 gusht 2019, <http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/4.pdf>

subjekteve politike. Slogani përfundimtar që është miratuar ishte “Trego fuqinë tënde – VOTO!” Me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të aktiviteteve të informimit publik, KQZ-ja kishte krijuar Këshillin Mbikëqyrës të Informimit Publik, në përbërje të pesë anëtarëve, tre prej të cilëve ishin anëtarë të KQZ-së, ndërsa dy anëtarë tjerë nga Sekretariati i KQZ-së.

Numri relativisht i lartë i fletëvotimeve të pavlefshme, që në këto zgjedhje është rreth 4%, gjegjësisht 33,271 sosh, prej të cilave 12,374 ishin të zbrazëta, përbën një indikator të qartë se informimi i publikut për procesin zgjedhor, në veçanti për procedurat e votimit nuk ka qenë në nivelin adekuat. Përpos arsyeve teknike, çalimit në informimin e duhur dhe të shënjestruar të publikut i ka kontribuar edhe periudha e shkurtër për informimin dhe edukimin e votuesve, sidomos për votuesit e rinj dhe grupet tjera që do të duhej të ishin prioritet i KQZ-së. KQZ-ja nëpërmjet procedurës së mbyllur të tenderimit me negociim, ka përzgjedhur një kompani të jashtme për të menaxhuar me komponentën e informimit dhe edukimit të votuesve. Sikur edhe në zgjedhjet e kaluara, janë shfaqur spote televizive në transmetuesin publik dhe mediat tjera. KQZ-ja, në fushatën për informim dhe edukim të votuesve në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, krahas mediave tradicionale ka përdorur edhe rrjetet sociale. Megjithatë, KQZ-ja nuk ka treguar qasje interaktive me publikun, ndonëse mediat sociale janë të konceptuara si komunikim i dyanshëm. Gjithashtu, nuk janë krijuar produkte të përshtatshme enkas për një kanal komunikimi. Produktet e prodhuara nga KQZ janë transmetuar në të gjitha mjetet e komunikimit, qoftë në televizione, radio apo rrjete sociale duke mos ju përshtatur specifikave të të gjitha kanaleve komunikuese.

Kur është fjala tek fushata ‘online,’ përveçse nuk janë kanë plasuar produkte të krijuara enkas për platformat elektronike, gjithashtu edhe plasimi i informacioneve nuk është bërë në përputhje me specifikat dhe kriteret e këtyre platformave. Në shumë raste, produktet janë plasuar pa një përshkrim apo kur ka pasur përshkrime ato kanë qenë tekste të gjata që destinim primar kanë pasur ueb faqen e KQZ-së.

Në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor, vlen të përmendet rasti i humbjes së 450 fletëvotimeve në vendvotimin 2114B/01R në komunën e Skënderajt. Si rezultat i nxjerrjes së këtyre fletëvotimeve jashtë vendvotimit, fillimisht PZAP kishte marrë vendim për ndalimin e pjesëmarrjes në zgjedhje për të gjithë anëtarët e KVV-së në fjalë dhe vëzhguesve tjerë të pranishëm. Kjo çështje kishte sjellë probleme edhe gjatë procesimit të të dhënave në QNR, pasi që vendvotimi në fjalë nuk ka mundur që të procesohet si i rregullt, për shkak të mungesës së fletëvotimeve në kuti dhe pamundësisë për kalimin e procesit të auditimit. Për këtë arsye, në një nga mbledhjet e saj, KQZ-ja, pas

rekomandimit nga QNR-ja, kishte marrë vendim për rritjen e nivelit të tolerancës së mospërputhjes së fletëvotimeve në +-450 vendvotimin në fjalë, në mënyrë që rezultatet të pranohen si të rregullta dhe të përfshihen në rezultatet përfundimtare.

## **5.2. Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve**

Emërimi i Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) ka hasur në vështirësi gjatë këtij procesi zgjedhor. Vendimi për emërimin e anëtarëve të KKZ-ve ishte marrë në përputhje me afatet në planin operacional, sipas të cilit ishte paraparë që emërimi i KKZ-ve të përfundojë më 4 shtator. Përkundër mospajtimeve të shumta lidhur me formulën e përbërjes së komisioneve mes anëtarëve të KQZ-së nga radhët e partive në pushtet dhe atyre në opozitë, KQZ-ja kishte miratuar vendimin për emërimin e anëtarëve në të gjitha komunat, duke përfshirë edhe nominimet nga subjektet politike të cilat kanë garuar në kuadër të një subjekti të vetëm në zgjedhjet e fundit parlamentare. Anëtarët nga radhët e subjekteve politike në opozitë (LDK dhe LVV) kishin kërkuar që formula e ndarjes të jetë bazuar në LPZ, i cili kërkon që anëtarët të nominohen vetëm nga subjektet politike që kanë garuar në zgjedhje dhe kanë kaluar pragun. Në komunat me numër të dallueshëm të komuniteteve jo-shumicë, KKZ-të kanë reflektuar përbërjen demografike të komunave përkatëse.

Për dallim nga zgjedhjet paraprake, kësaj here është shënuar progres domethënës sa i përket transparencës së KKZ-ve. Rreth 80% e mbledhjeve të mbajtura nga KKZ-të janë paralajmëruar për publikun, ndërsa pothuajse të gjitha procesverbalet janë evidentuar në librat e protokolleve. Në të gjitha mbledhjet e vëzhguara nga DnV-ja është ofruar qasje në dokumentacionin e KKZ-së për të gjithë vëzhguesit. Divizioni përkatës në SKQZ ka ushtruar mbikëqyrje të rregullt dhe strikte të funksionimit të KKZ-ve.

Përkundër thirrjeve nga DnV-ja që subjektet politike të nominojnë më shumë gra në këto komisione, sërish përfshirja e grave në KKZ mbetet shumë e ulët. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të KKZ-ve, vetëm 16% e tyre ishin gra. Po ashtu, vetëm katër nga gjithsej 38 kryesuesit e KKZ-ve ishin gra.

Përbërja e kryesuesve dhe anëtarëve të Këshillave të Vendvotimit ka përfshirë subjektet politike të cilat janë certifikuar për të garuar në zgjedhjet e 6 tetorit, duke reflektuar përbërjen e KKZ-ve në nivel të komunës përkatëse. Ndonëse sipas planit operacional ishte paraparë emërimi i KVV-ve deri më 22 shtator, vendimi për përbërjen e tyre ishte marrë me dy ditë vonësë.

Për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve, KQZ-ja ka angazhuar 17 mijë persona në Këshillat e Vendvotimeve. Si staf

ndihmës, nga KKZ-të janë përfshirë mbi 9 mijë persona, ndërsa janë angazhuar rreth 300 anëtarë në 110 ekipet mobile që KQZ-ja ka pasur në dispozicion.

**Prania e grave në trupat për administrimin e zgjedhjeve** mbetet e ulët. Përkundër dakordimit në mes të subjekteve politike për përfaqësim të grave në administrim të zgjedhjeve në nivelin prej të paktën 40%, edhe në këto zgjedhje vetëm 32% e Këshillave të Vendvotimeve kanë qenë të përbëra nga gratë.<sup>12</sup>

### 5.3. Qendra e Numërimit dhe Rezultateve

QNR-ja, sipas përcaktimit ligjor, është lokacioni ku pranohet materiali zgjedhor nga vendvotimet, procedohen formularët e zgjedhjeve, numërohen votat me kusht, votat me postë dhe fletëvotimet tjera sipas kërkesës së KQZ-së apo PZAP-së.<sup>13</sup> Organizimi, funksionimi dhe procedurat e numërimit të QNR-së janë të përcaktuara në Rregullën Zgjedhore Nr. 06/2013 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Për zgjedhjet e 6 tetorit, QNR-ja ka pasur të angazhuar rreth 700 persona.

Në këto zgjedhje, QNR-ja ka qenë dukshëm më e angazhuar, si rezultat i numrit të madh të vendvotimeve që janë rinumëruar. Fillimisht, pas vendimit të KQZ-së, ishin rinumëruar 840 vendvotime, apo 33% e të gjitha vendvotimeve. Pjesa më e madhe e këtyre vendvotimeve ishin rinumëruar si rezultat i mospërputhjeve në Formularin e Përputhjes së Rezultateve (FPR), sidomos mes votave të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. Pjesa tjetër e vendvotimeve nuk janë procesuar si të rregullta për shkak të lëshimeve të bëra nga ana e komisionerëve gjatë përshkrimit të rezultateve. Rinumërimi i këtyre kutive ishte zhvilluar në rreth 20 tavolina të numërimit, me një mesatare prej rreth 80 kutive të rinumëruara në ditë.

Pas vendimit të PZAP-së, QNR-ja ka rinumëruar edhe 1,407 kuti të tjera, duke e quar numrin e përgjithshëm të vendvotimeve të rinumëruara në 2,247, apo 88.2% e numrit të tërësishëm të vendvotimeve në vend. Për rinumërimin e këtyre kutive, ishte shtuar numri i tavolinave të numërimit në 33 sosh, duke rritur automatikisht numrin e vendvotimeve të rinumëruara në ditë për rreth 30%, me mesatarisht 120 vendvotime të rinumëruara në ditë.

---

<sup>12</sup> Nënshkrimi i Deklaratës për rritjen e përfshirjes së grave në proceset zgjedhore. D4D. Qasur në: <https://d4d-ks.org/aktivitetet/nenshkrimi-i-deklarates-per-rritjen-e-perfshirjes-se-grave-ne-proceset-zgjedhore/>

<sup>13</sup> Neni 3, Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare, 15 qershor 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>



Puna në QNR ka qenë e hapur dhe transparente për publikun, ndërsa procesi i rinumërimit në përgjithësi ka ndikuar në rritjen e integritetit zgjedhor, duke evituar të gjitha parregullsitë e evidentuara gjatë pranimit të materialeve apo pas vendimeve për rinumërim nga PZAP-ja. Filtrat e shumëfishtë sigurisë që zbatohen në QNR, veçanërisht gjatë procesimit të të dhënave, kanë garantuar proces kredibil, duke evituar çfarëdo mundësie për manipulim. Të gjitha subjektet politike, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat kanë pasur të drejtën e dërgimit të vëzhguesve në QNR, në proporcion me numrin e tavolinave në të cilat është zhvilluar numërimi apo rinumërimi.

#### 5.4. **Certifikimi i listës së votuesve dhe Shërbimi i Votuesve**

Lista preliminare e votuesve, që buron nga ekstrakti i Regjistrin Qendror Civil ka përfshirë 1,972,466 votues. Sipas planit operacional të KQZ-së, votuesve iu ishte dhënë afat prej vetëm tre ditësh, prej të cilave një ishte ditë fundjave, për kundërshtimin e listës së votuesve. Ky afat i shkurtër kishte ndikuar që qytetarët të mos kenë hapësirën e nevojshme kohore për të sfiduar listën.

Në bazë të afateve kohore të caktuara nga KQZ, 19 shtatori ishte caktuar si datë për certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve. Lista Përfundimtare e Votuesve brenda vendit përbëhej nga gjithsej **1,937,868 votues**. Ndërsa, numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në këto zgjedhje ishte 1,961,213 votues, apo 73,145 votues më shumë sesa në zgjedhjet e fundit parlamentare të 11 qershorit të vitit 2017.

Sipas nenit 5 të LPZ, të drejtën për të votuar në zgjedhjet në Kosovë e kanë të gjithë personat që i kanë mbushur 18 vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet, të cilët janë të regjistruar si qytetarë të Kosovës në Regjistrin Qendror Civil, banojnë jashtë Kosovës apo ata që kanë fituar statusin e refugjatit.

Numri i votuesve të rinj që kanë fituar të drejtën e votës për herë të parë në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës ishte **111,733 votues**, prej të cilëve **87,180** ishin **votues të rinj** që pas zgjedhjeve lokale të vitit 2017 kanë arritur moshën 18 vjeçare. Numri i votuesve që janë konsideruar si votues të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile pas zgjedhjeve lokale të 2017, e që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve në Zgjedhjet Lokale 2017 në total ishte **24,553 votues**. Ndërsa, numri i personave të vdekur që janë larguar pas Zgjedhjeve Lokale 2017 dhe numri i votuesve që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës ishte gjithsej 46,917 votues.

Numri i Qendrave të Votimit në këto zgjedhje ka qenë 895 (6 Qendra të Votimit më shumë se në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017), me gjithsej 2,547

Vendvotime (57 Vendvotime më shumë se në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017).

Disa nga problematikat që kanë shoqëruar procesin e përpilimit të Listës Përfundimtare të Votuesve kanë qenë të ndërlidhura me përfshirjen e personave të vdekur, por edhe mos përfshirjen e votuesve të cilët kanë nxjerrë së fundmi dokumente të Republikës së Kosovës.

Sipas afateve të aktiviteteve zgjedhore, periudha prej 3 deri më 14 shtator ishte caktuar si Periudha për Shërbimin e Votuesve. Gjatë kësaj periudhe, votuesit kanë pasur mundësinë që të informohen për Qendrën e Votimit ku ata do të ushtronin të drejtën e tyre të votës, apo eventualisht të kërkojnë ndryshimin e saj. Në periudhën në fjalë, janë parashtruar 5,545 kërkesa për ndërrimin e qendrave të votimit, pjesa më e madhe e të cilave përmes aplikacionit 'online' të KQZ-së.

KQZ-ja kishte marrë vendim edhe për rritjen e numrit maksimal të votuesve në vendvotim në 950 votues, për dallim nga përcaktimi ligjor prej maksimalisht 750 votues për vendvotim.

## **5.5. Regjistrimi dhe certifikimi i kandidatëve**

Afati i aplikimit për certifikim të subjekteve politike për këto zgjedhje filloi nga data 27 gusht dhe përfundoi më 6 shtator, që ishte caktuar si afat për dorëzimin e listave fillestare të kandidatëve për deputetë. Kurse certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve është bërë më 9 shtator 2019. Për të marrë pjesë në zgjedhje, KQZ-ja ka certifikuar 25 subjekte politike, prej të cilave ishin katër koalicione, 20 parti politike dhe një kandidat i pavarur. Sipas ndarjes në baza etnike të subjekteve politike që janë certifikuar, përpos kandidatit të pavarur që ishte nga komuniteti boshnjak, shtatë ishin subjekte politike nga komuniteti shqiptar, katër nga komuniteti serb, tri nga komuniteti boshnjak, tri nga komuniteti goran, tri nga komuniteti ashkali, dy nga komuniteti rom dhe nga një subjekt nga komuniteti turk dhe ai egjiptian.

Numri fillestar i kandidatëve të subjekteve politike ka qenë 1,070, por pas decertifikimit nga PZAP-ja dhe zëvendësimit të disa kandidatëve, ky numër ka zbritur në 1,067 sosh. Ndërsa, nga numri i përgjithshëm i kandidatëve të certifikuar, 725 kandidatë janë burra, ndërsa vetëm 343, apo 32%, janë gra. Kjo nënkupton që pothuajse të gjitha subjektet politike kanë përmbushur vetëm kërkesën minimale prej të paktën 30% të përfaqësimit të grave në lista, përkundër thirrjeve të shumta për përfshirjen e barabartë të të dy gjinive në lista.

KQZ-ja ka zbatuar rekomandimin e DnV-së nga raporti i zgjedhjeve të kaluara për të evituar mundësinë që kandidatët të kenë numër të njëjtë me atë të subjekteve politike. Kjo është bërë me qëllim që të shmanget mundësia që votuesit të votojnë kandidatët duke menduar se po votojnë për subjektin politik. Kësaj radhe, subjektet politike u renditën nga numri 111 dhe më lartë, duke garantuar kështu garë të barabartë dhe mos diskriminim të asnjë prej kandidatëve brenda listave të subjekteve politike.

Sipas ligjit në fuqi të Republikës së Kosovës, secili subjekt politik mund të ketë deri në 110 kandidatë për deputetë në listat e veta, apo 10% më shumë se numri i vendeve për të cilat garohet.


## **5.6. Votimi jashtë vendit**

Votimi nga jashtë vendit i realizuar përmes postës është cilësuar si një nga çështjet më të ndjeshme dhe problematike të këtyre zgjedhjeve. Ky proces është shoqëruar me sfida, të cilat kanë ndikuar edhe në integritetin e procesit zgjedhor. Pakot me fletëvotime të supozuara që kanë ardhur me vonesë nga jashtë vendit, si dhe mënyra e organizuar e transportit të pakove nga Serbia, janë dy çështjet kryesore që kanë karakterizuar këtë proces.

Operacioni për regjistrimin e votuesve jashtë vendit kishte filluar më 30 gusht dhe ishte përmbyllur më 10 shtator. Për përmbylljen e këtij procesi brenda afateve të parapara, KQZ-ja kishte marrë vendim për shtimin e stafit që është marrë me verifikimin e aplikacioneve dhe regjistrimin e votuesve jashtë vendit. Mekanizmat e vënë në dispozicion nga KQZ-ja për regjistrimin e këtyre votuesve ishin votimi përmes adresës elektronike, postës dhe faksit. Mbi 85% e aplikacioneve janë pranuar përmes adresave elektronike të hapura nga KQZ-ja, përkundër që kjo mënyrë e aplikimit nuk parashihet me ligj. Në këtë drejtim, është shënuar progres në procesimin e tyre, si dhe nuk janë shfaqur ankesa për bllokimin e serverëve, siç kishte ndodhur në zgjedhjet paraprake. Pjesa tjetër e votuesve kanë aplikuar përmes postës, pjesa dërrmuese e të cilave nga Serbia, si dhe një pjesë e vogël e aplikacioneve kanë ardhur përmes faksit.

Numri i qytetarëve të interesuar për votim nga jashtë vendit ka qenë më i madh në këto zgjedhje dhe numri i përgjithshëm i votave nga jashtë vendit është dyfishuar në krahasim me zgjedhjet e kaluara. Sipas të dhënave të ofruara nga Sekretariati i KQZ-së, për regjistrim jashtë Kosovës kanë aplikuar 40,313 persona, apo 19,959 më shumë se në zgjedhjet e 2017. Nga ky numër, KQZ-ja ka miratuar 35,087 votues, kurse janë refuzuar 5,226 aplikacione. Shtetet prej nga kanë ardhur më së shumti aplikacione dhe që janë aprovuar, janë: Gjermania (11,449), Zvicra (9,842), Serbia (4,337), Austria (1,387) dhe Italia (1,137).

## Numri i aplikimeve për votim nga jashtë Kosovës



**Figura 1:** Aplikimet për votim nga jashtë, krahasimi mes zgjedhjeve 2017 dhe 2019

Nga numri i përgjithshëm prej 5,226 aplikacioneve të pavlefshme, 32 aplikues janë refuzuar për shkak se kanë qenë nën moshën 18 vjeçare, 2,338 kanë aplikuar me dokumente valide të identifikimit, por që nuk kanë dërguar dokumente me të cilat do të vërtetohej njëra nga kriteret e zotësisë juridike për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës, kurse 2,856 aplikues janë refuzuar për shkak që kanë dërguar vetëm formularin e aplikimit për regjistrim dhe duke mos dëshmuar identitetin, kusht ligjor ky për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës. Shtetet prej nga janë refuzuar më së shumti aplikacione, janë Gjermania (1,766), Zvicra (1,313) dhe Serbia (770). Në listën e votuesve jashtë vendit ishin përfshirë edhe dhjetëra votues të cilët, ndonëse fillimisht ishin refuzuar nga KQZ-

ja, me vendim të PZAP-së ishin përfshirë në listë. Të njëjtëve, në Listën Përfundimtare të Votuesve, në kolonat përkatëse iu është vendosur një shenjë për të pamundësuar keqpërdorimet eventuale në emër të tyre. Në këtë drejtim, pamundësia e sfidimit të listës së votuesve jashtë vendit vazhdon të mbetet një nga problemet që shoqëron në vazhdimësi procesin e votimit jashtë vendit. Kjo ndikon që votuesit të mos kenë mundësi që të kundërshtojnë listën, edhe nëse në të njëjtën evidentohen parregullsi të caktuara.

Numri i përgjithshëm i votuesve nga jashtë të cilët e kanë ushtruar suksesshëm të drejtën e tyre të votës është 20,191 sosh. Prej tyre, 19,789 vota kanë qenë të vlefshme, që përbëjnë 2.72% e numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme, kurse 264 fletëvotime kanë qenë të pavlefshme dhe 138 tjera kanë qenë të zbrazëta. Në numrin e përgjithshëm të qytetarëve që kanë ushtruar të drejtën e votës nga jashtë vendit janë përfshirë edhe mbi 6 mijë qytetarë, pakot me fletëvotime të cilëve kanë ardhur me vonesë. Ndërsa, ndonëse fillimisht në rezultatet e shpallura nga KQZ-ja ishin përfshirë mbi 3 mijë votues tjerë që kanë votuar nga Serbia, fletëvotimet e tyre ishin anuluar nga PZAP-ja dhe nuk ishin përfshirë në rezultatit e certifikuar.

Fillimisht, pas përfundimit të numërimit të 13,491 fletëvotimeve të ardhura me 11,922 dërgesa të rregullta postare, në PZAP ishte paraqitur apel për verifikimin dhe numërimin e 4,639 pakove me fletëvotime të supozuara, të cilat kishin në

fahun postar të KQZ-së jashtë afatit të përcaktuar ligjor prej 24 orësh. Vonesat e kompanive postare në sjelljen e dërgesave postare dhe falimentimi i një kompanie ajrore që ka qenë përgjegjëse për sjelljen e një pjese të këtyre pakove, janë dy nga arsyet kryesore që janë listuar si shkaktarë të arritjes pas afatit të pjesës më të madhe të zarfeve të supozuara me fletëvotime të ardhura me vonesë nga jashtë vendit. PZAP-ja kishte hedhur si të palejueshëm këtë apel, në mungesë të një vendimi të KQZ-së lidhur me këtë çështje juridike.<sup>14</sup> Megjithatë, pas ankesës së Lëvizjes Vetëvendosje në Gjykatën Supreme, e njëjta kishte kthyer lëndën në PZAP në rishqyrtim dhe rivendosje, duke sugjeruar që çështja të trajtohet duke u bazuar edhe në dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Pas shqyrtimit të ri që PZAP-ja i kishte bërë kësaj çështje, sërish kishte vendosur për mospranimin e pakove me fletëvotime të ardhura me vonesë, duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, pas konstatimit se ka pasur shkelje të dispozitave përkatëse të LPZ dhe Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, të cilat përcaktojnë se të gjitha votat nga jashtë duhet të pranohen një ditë, përkatësisht 24 orë, para ditës së zgjedhjeve.<sup>15</sup>

Vendimi i PZAP-së ishte ankimuar sërish në Gjykatën Supreme, dhe e njëjta kishte vendosur për anulimin e vendimit paraprak të PZAP-së, duke e urdhëruar kështu KQZ-në që të numërojë të gjitha fletëvotimet e votuesve jashtë Kosovës. Vendimi i Gjykatës Supreme ishte arsyetuar mbi bazën e interpretimit të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke vlerësuar se dispozitat e LPZ dhe rregullës përkatëse zgjedhore që rregullojnë ardhjen e fletëvotime nga jashtë, janë në kolizion me këtë dokument.

Më tutje, KQZ-ja kishte njoftuar që në fahun e saj postar, më 17 tetor kanë arritur edhe 1,806 pako tjera me fletëvotime të supozuara, por që nuk kishte marrë vendim për numërimin apo refuzimin e tyre. Si rrjedhojë, sërish ishte parashtruar apel në PZAP për verifikimin dhe numërimin e këtyre pakove. Paneli, megjithatë, kishte vendosur edhe një herë kundër pranimin të këtyre pakove. Por, si rezultat i një vendimi tjetër nga Gjykata Supreme, të njëjtat ishin pranuar dhe numëruar në QNR.<sup>16</sup>

---

<sup>14</sup> Për më shumë, shih vendimin Anr. 375/2019 të PZAP-së, të datës 20 tetor, 2019. I qasshëm në: <http://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/10/A375-2019-Vendim.pdf>

<sup>15</sup> Për më shumë, shih vendimin Anr. 375-2/2019 të PZAP-së, të datës 28 tetor, 2019. I qasshëm në: <http://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/10/A375-2-2019-Vendim.pdf>

<sup>16</sup> Për më shumë, shih vendimin Anr. 381/2019 të PZAP-së, të datës 3 nëntor, 2019. I qasshëm në: <http://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/11/A381-2019-Vendim.pdf>

Vendimet e Gjykatës Supreme lidhur me këtë çështje, përpos që kishin shfuqizuar *de-facto* një pjesë të dispozitave ligjore të votimit nga jashtë, kishin krijuar një precedent të gabuar për ciklet e ardhshme zgjedhore. Kjo pasi që, pranimi i pakove me fletëvotime të ardhura me vonesë mund të ndikojë negativisht në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, si dhe mund të prolongojë panevojshëm proceset zgjedhore.

Problematikë tjetër që ka shoqëruar operacionin e votimit jashtë vendit janë votat e ardhura nga Serbia, që ishin gjithsej rreth 4 mijë sosh. Ky proces, ishte kthyer në çështje të diskutimit publik, fillimisht pasi që gjatë verifikimit të këtyre pakove ishin shfaqur probleme shëndetësore tek mbi 20 punonjës të KQZ-së. Kjo kishte rezultuar me pezullimin e përkohshëm të procesit të verifikimit. Pas rreth 10 ditësh, nën masa të shtuara të sigurisë, kishte vijuar procesi i verifikimit, dhe pakot e konfirmuara ishin dërguar në të njëjtën ditë për numërim në QNR.

Që nga fillimi i verifikimit të tyre, këto pako kanë qenë objekt i tri ankesave të parashtruara në PZAP nga koalicioni NISMA-AKR-PD, prej të cilave dy janë refuzuar, ndërsa një tjetër është pranuar. Ankesa e parë ishte dërguar një ditë pas numërimit të këtyre votave në QNR, me kërkesën për anulimin e tyre, mirëpo e njëjta ishte hedhur si e palejuar, pasi që ishte konstatuar se ka mungesë të një vendimi të KQZ-së lidhur me këto fletëvotime, në fazën kur është parashtruar ankesa.<sup>17</sup> Ankesa tjetër ishte parashtruar më 28 tetor, me anë të së cilës ishte kontestuar procedura dhe mënyra e pranimi të votave individuale. Edhe kjo ankesë ishte refuzuar, pasi që sipas PZAP-së, e njëjta ishte e pasafatshme.<sup>18</sup> Ndërsa, ankesa e fundit ishte dorëzuar pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja. Me këtë ankesë ishte kontestuar sërish procedura e sjelljes së tyre në Kosovë dhe e njëjta ishte aprovuar nga PZAP-ja, duke e urdhëruar KQZ-në që të njëjtat t'i largojë nga rezultati përfundimtar i zgjedhjeve.<sup>19</sup> Problemi kryesor i këtyre votave, del të jetë fakti që të njëjtat nuk janë nisur si dërgesa postare nga shteti i origjinës (Serbia), për dallim nga pesë zarfe tjera të votuesve të regjistruar në këtë shtet, e që kanë ardhur në procedurë të rregullt postare nga Maqedonia Veriore. Këto zarfe janë dorëzuar fizikisht në fahun përkatës të KQZ-së nga dy persona, por që të njëjtat nuk kanë pasur postën dërguese por vetëm atë pranuese.

---

<sup>17</sup> Për më shumë, shih vendimin Anr. 378/2019 të PZAP-së, të datës 25 tetor, 2019. I qasshëm në: <http://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/10/A378-2019-Vendim.pdf>

<sup>18</sup> Për më shumë, shih vendimin Anr. 380/2019 të PZAP-së, të datës 30 tetor, 2019. I qasshëm në: <http://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/10/A380-2019-Vendim.pdf>

<sup>19</sup> Për më shumë, shih vendimin Anr. 428/2019 të PZAP-së, të datës 10 nëntor, 2019. I qasshëm në: <http://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/11/A428-2019-Vendim.pdf>

Me anë të këtij vendimi ishte kontestuar edhe praktika e deritanishme e pranimit të votave të ardhura nga Serbia që nga viti 2013, për të cilën PZAP-ja kishte konstatuar që nuk ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Vlen të përmendet që vendimi i PZAP-së për largimin e këtyre fletëvotimeve nga rezultati përfundimtar është sfiduar në Gjykatën Supreme nga disa subjekte politike apo kandidatët e tyre, mirëpo që ankesat në fjalë nuk janë aprovuar.

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja më 7 nëntor, në fahun postar të KQZ-së kishin ardhur edhe 392 pako të supozuara me fletëvotime nga jashtë vendit. Për shkak të mos numërimit të tyre, LVV-ja kishte parashtruar ankesë në PZAP dhe pastaj në Gjykatën Supreme, ankesë kjo e cila ishte refuzuar nga këto dy instanca.

## 6. Fushata Zgjedhore

Meqenëse zgjedhjet ishin të parakohshme, edhe periudha kohore për fushatë për subjektet politike ka qenë më e shkurtër. Fushata zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës u vendos të zgjasë dhjetë ditë, nga 25 shtator deri më 4 tetor. Subjektet politike, duke shfrytëzuar mungesën e hapësirës ligjore filluan aktivitetet e tyre parazgjedhore qysh nga dita e shpalljes së zgjedhjeve nga presidenti i vendit. Duke filluar aktivitetet e fushatës zgjedhore para fillimit zyrtar të fushatës, subjektet politike nuk i nënshtrohen kufizimeve për shpenzim të mjeteve financiare gjatë fushatës. Gjithashtu, subjektet politike nuk janë subjekt i ankesave në PZAP për shkelje të Kodit të Mirësjelljes para fillim zyrtar të fushatës zgjedhore.

Subjektet politike në përgjithësi kanë realizuar një fushatë zgjedhore të matur, ku kishte pjesëmarrje të konsiderueshme të qytetarëve. Gjatë dhjetë ditëve të fushatës nuk janë vërejtur incidente të mëdha, mirëpo ka pasur akuza nga subjektet tjera serbe në Kosovë se Lista Serbe ka përdorur shantazh dhe kërcënime në zonat e banuara nga komuniteti serb.<sup>20</sup> Sipas tyre, Lista Serbe ka përdorur gjuhë kërcënuese dhe intimiduese ndaj tyre,<sup>21</sup> ndërsa qytetarëve iu është bërë presion për të votuar Listën Serbe.<sup>22</sup>

---

<sup>20</sup> "Partitë e tjera serbe në Kosovë akuzojnë Listën Serbe për kërcënime e shantazhe". Koha Ditore, qasur më 29.11.2019 në: <https://www.koha.net/zgjedhjet-2019/185964/partite-e-tjera-serbe-ne-kosove-akuzojne-listen-serbe-per-kercenime-e-shantazhe/>

<sup>21</sup> Për më shumë, shih lajmin: <https://zeri.info/zgjedhjet-2019/289882/kercenon-ls-ja-vota-e-serbeve-te-kosoves-vetem-per-kandidatet-e-listes-serbe/>

<sup>22</sup> Për më shumë, shih lajmin: <https://www.koha.net/zgjedhjet-2019/187077/beogradi-me-ultimatum-urdheron-serbet-ne-kosove-te-votojne-per-listen-serbe/>

Gjatë dhjetë ditëve zyrtare të fushatës zgjedhore vëzhguesit e DnV-së kanë monitoruar gjithsej 787 aktivitete, prej të cilave 83% ishin tubime publike, në të cilat morën pjesë rreth 270 mijë qytetarë. Gjithashtu, ka pasur aktivitete të llojit “derë më derë,” shtande në ambiente publike dhe takime me grupe të interesit.

Me qëllim të prezantimit të programit qeverisës të tyre, subjektet politike janë fokusuar në disa tema kyçe. Përkundër që zgjedhjet ishin të parakohshme, shumica e subjekteve politike kanë arritur të përpilojnë programet e tyre zgjedhore, mbi bazën e të cilave janë zhvilluar edhe diskutime për ofertat programore. Ndër temat më të shtjelluara nga subjektet politike gjatë kësaj fushate zgjedhore ishin ekonomia, arsimi dhe shëndetësia. Përveç këtyre, të gjitha subjektet politike i dhanë rëndësi edhe punësimit edhe pse kësaj radhe nuk premtuan krijimin e vendeve të punës në shifra enorme, por më shumë në kuadër të zhvillimit ekonomik dhe krijimin e kushteve të mirëfillta për investime të huaja. Sipas raportimeve të vëzhguesve të DnV-së, në 58.5% të të gjitha aktiviteteve, subjektet politike i kanë kushtuar rëndësi të veçantë edhe edukimit të votuesve duke iu shpjeguar mënyrën se si duhet të votohet.

Sikurse në fushatat zgjedhore paraprake, as kësaj radhe nuk pati mungesë të përdorimit të gjuhës ofenduese nga subjektet politike ndaj rivalëve të tyre. Gjatë dhjetë ditëve të fushatës zgjedhore janë evidentuar 53 raste të përdorimit të gjuhës ofenduese nga subjektet politike, prej të cilave 49 raste kanë qenë në baza politike, dy në baza etnike dhe dy në baza gjinore.

Përkundër premtimeve të shumta nga subjektet politike për hapësirë më të madhe për gratë, përfshirja e tyre ende mbetet në nivele të ulëta. Në të gjitha aktivitetet e organizuara nga subjektet politike, vetëm 25.3% e folësve kanë qenë gra, derisa nga numri i përgjithshëm i qytetarëve që kanë marrë pjesë në këto aktivitete, vetëm rreth 25% e tyre kanë qenë gra. Edhe pse pjesëmarrja e grave në tubime të tilla ka qenë më e lartë në krahasim me zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, nuk është një rritje e kënaqshme. Kjo dëshmon që grave ende nuk iu ofrohet hapësirë e barabartë për të shpalosur idetë e tyre duke bërë garën zgjedhore të pabarabartë dhe më pak të favorshme për gratë.

Pavarësisht se në Kosovë jetojnë rreth 250 mijë persona me aftësi të kufizuara,<sup>23</sup> pjesëmarrja e tyre në aktivitete zgjedhore ka qenë shumë ulët, pasi që në 787 aktivitete të monitoruara nga DnV-ja, me rreth 270 mijë qytetarë pjesëmarrës, vetëm 247 prej tyre kanë qenë persona me aftësi të kufizuara. Mungesa e

---

<sup>23</sup> Numri i personave me aftësi të kufizuara sipas statistikave të publikuara nga organizata HANDIKOS.



infrastrukturës së duhur për qasje të personave me aftësi të kufizuara ka vështirësuar dhe më tej pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet zgjedhore. Në 27.5% të aktiviteteve zgjedhore nuk është garantuar qasje fizike adekuate për ta. Gjatë fushatës zgjedhore, vetëm katër persona me aftësi të kufizuara kanë qenë folës.

Fenomeni i pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitetet zgjedhore ka vazhduar edhe kësaj radhe. Ani pse rregulla zgjedhore sanksionon pjesëmarrjen e fëmijëve nën moshën 15 vjeçare, subjektet politike kanë shfrytëzuar pjesëmarrjen e tyre me tendencën për të krijuar avantazh politik. Gjithsej, rreth 4,200 fëmijë kanë qenë pjesëmarrës në aktivitetet zgjedhore. Nga 252 raste sa janë evidentuar, 89% e pjesëmarrjes së fëmijëve ka qenë spontane, ndërsa pjesëmarrja ka qenë e organizuar në 11% të rasteve.

Legjislacioni në fuqi ndalon përdorimin e resurseve publike, financiare dhe njerëzore nga subjektet politike në pushtet, pasi që përdorimi i tyre krijon avantazh të dallueshëm dhe çrregullon parimin e garës së barabartë në mes të subjekteve. Megjithatë, ky fenomen është evidentuar në gjithsej 38 aktivitete, në të cilat është evidentuar përdorimi i 93 veturave zyrtare dhe në 124 raste është vërejtur pjesëmarrje e shërbyesve publik.

Me shkurtimin e periudhës kohore të fushatës zgjedhore, është shkurtuar edhe periudha e paralajmërimit të aktiviteteve nga subjektet politike në KKZ-të përkatëse. Nga 72 orë sa është në kushte normale, subjektet politike është dashur të paralajmërojnë aktivitetin e tyre zgjedhor më së largu deri në 24 orë para mbajtjes së aktivitetit. Ky rregull nuk është respektuar plotësisht nga subjektet politike, meqenëse 17% e të gjitha aktiviteteve zgjedhore janë mbajtur pa u paralajmëruar fare.

## 6.1. Shpenzimet e Subjekteve Politike

Në bazë të *Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme*, KQZ-ja është institucioni i cili përcakton shumën maksimale që mund të shpenzohet nga subjektet politike për organizimin e aktiviteteve zgjedhore. Në bazë të ligjit, KQZ-ja përcakton këtë kulm të shpenzimeve duke u mbështetur në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve në kohën e freskimit të fundit të saj. Duke u nisur nga kjo, KQZ-ja përcaktoi që shuma më e lartë që subjektet politike mund të shpenzojnë për aktivitete zgjedhore të jetë 986,233 euro, bazuar në formulën si në vijim:

[0.50 euro x Numri i Votuesve të Regjistruar = Shuma Maksimale për Shpenzim]

Me qëllim të rritjes së transparencës së shpenzimeve gjatë fushatës zgjedhore, DnV-ja u ka dërguar një pyetësor elektronik të gjitha subjekteve politike në garë

për të treguar shumat që planifikojnë të shpenzojnë në fushatë, mënyrën e financimit, udhëheqësit e fushatës dhe të tjera. Nga 26 subjekte sa janë kontaktuar, vetëm pesë prej tyre kanë plotësuar pyetësonin në fjalë. Kjo dukuri hedh ne pah mungesën të transparencës nga subjektet politike përkundër thirrjeve të vazhdueshme nga akterë të ndryshëm për një gjë të tillë, si dhe avokimi dhe zotimet e tyre për transparencë dhe llogaridhënie.

Gjatë fushatës zgjedhore dhjetë ditore, DnV-ja ka raportuar vazhdimisht për ngjarjet dhe shpenzimet e subjekteve politike për organizimin e aktiviteteve të fushatës së tyre zgjedhore. Raportimi për ngjarjet e vëzhguara gjatë fushatës zgjedhore është bërë në baza treditore. Fillimi i fushatës zgjedhore ka qenë i hovshëm, me organizime madhështore të hapjes së fushatës nga subjektet politike, dhe si rrjedhojë edhe shpenzime mjaft të larta nga subjektet politike. Vetëm në tre ditët e para të fushatës zgjedhore, bazuar nga vëzhgimet e ngjarjeve, subjektet politike për organizimin e aktiviteteve të tyre kanë shpenzuar rreth **1 milionë e 65 mijë euro**. Shpenzimet për organizim të aktiviteteve kanë rënë dukshëm në ditët pasuese. Në treditëshin e dytë subjektet politike kanë shpenzuar rreth **504 mijë euro**, derisa në katër ditët e fundit të fushatës subjektet politike kanë shpenzuar rreth **723 mijë euro**. Bazuar në këtë kalkulim të shpenzimeve, për organizimin e aktiviteteve të fushatës zgjedhore, subjektet politike kanë shpenzuar gjithsej rreth **2 milionë e 293 mijë euro**.

Për të pasur një pasqyrë më të detajuar të shpenzimeve, DnV-ja ka monitoruar shpenzimet për secilin subjekt politik veçmas, duke i ndarë shpenzimet për aktivitete të fushatës dhe shpenzimet për hapësira reklamuese. Sipas kalkulimeve, vetëm për organizimin e aktiviteteve të fushatës zgjedhore, LDK-ja ka qenë subjekti që ka shpenzuar më së shumti me rreth 830 mijë euro, pasuar nga PDK-ja me rreth 477 mijë euro, LVV-ja me afërsisht 356 mijë euro, koalicioni AAK-PSD me rreth 302 mijë euro, koalicioni NISMA – AKR – PD me rreth 174 mijë euro, Lista Serbe me rreth 91 mijë euro, dhe subjektet e tjera politike me 60 mijë euro.

	25-27 shtator	28-30 shtator	1-3 tetor	4 tetor	Gjithsej
LDK	€ 577,961	€ 124,085	€ 79,600	€ 48,733	€ 830,378
PDK	€ 150,005	€ 131,524	€ 165,431	€ 30,525	€ 477,485
LVV	€ 106,370	€ 110,731	€ 108,469	€ 31,128	€ 356,698
AAK - PSD	€ 88,378	€ 65,104	€ 99,951	€ 50,283	€ 302,716
NISMA - AKR - PD	€ 84,597	€ 41,957	€ 31,755	€ 16,444	€ 174,753
Lista Serbe	€ 43,587	€ 18,011	€ 28,797	€ 658	€ 91,053
Të tjera	€ 14,647	€ 13,821	€ 21,676	€ 10,030	€ 60,174
<b>Gjithsej</b>	<b>€ 1,065,545</b>	<b>€ 504,232</b>	<b>€ 535,679</b>	<b>€ 187,802</b>	<b>€ 2,293,258</b>


**Tabela 1:** Shpenzimet për organizimin e aktiviteteve të fushatës zgjedhore, sipas subjekteve politike

Duke u bazuar në të dhënat e mbledhura nga monitorimi i mediave, subjektet politike kanë shpenzuar rreth **249 mijë e 894 euro** për spote reklamuese, rreth **328 mijë e 650 euro** për transmetim e tubimeve në televizione, si dhe rreth **764 mijë euro** për transmetim të drejtpërdrejt në rrjetin social “Facebook.”

	Spote reklamuese	Tubime	“Facebook Live”	Gjithsej
LDK	€ 43,129.2	€ 70,583.3	€ 263,100.0	€ 376,812.5
PDK	€ 79,126.8	€ 92,458.3	€ 170,200.0	€ 341,785.1
LVV	€ 11,716.2	€ 31,500.0	€ 13,800.0	€ 57,016.2
AAK - PSD	€ 84,390.6	€ 88,725.0	€ 220,800.0	€ 393,915.6
NISMA - AKR - PD	€ 19,017.6	€ 31,558.33	€ 93,700.0	€ 144,275.9
Lista Serbe	€ 4,754.4	€ 13,825.0	€ 2,800.0	€ 21,379.4
SLS	€ 3,735.6	€ 0	€ 0	€ 3,735.6
Të tjera	€ 4,024.3	€ 0	€ 0	€ 4,024.3
<b>Gjithsej</b>	<b>€ 249,894.7</b>	<b>€ 328,650.0</b>	<b>€ 764,400.0</b>	<b>€ 1,342,944.7</b>

**Tabela 2:** Shpenzimet për hapësira reklamuese gjatë fushatës zgjedhore, sipas subjekteve politike

Si përfundim, duke përfshirë shpenzimet për organizim të aktiviteteve gjatë fushatës zgjedhore dhe shpenzimet për reklamim apo transmetim të ngjarjeve të fushatës zgjedhore, subjektet politike të monitoruara kanë shpenzuar gjithsej rreth **3 milionë e 636 mijë euro** gjatë fushatës zgjedhore 10 ditore. Nga subjektet e monitoruara, del se vetëm LDK nuk e ka respektuar kufizimin për shpenzimet maksimale gjatë fushatës, duke shpenzuar 220,957 euro më shumë se limiti i përcaktuar nga KQZ. Ndërsa, subjektet tjera kanë shpenzuar brenda kufizimit prej 986,233 eurove.



**Figura 2:** Shpenzimet e përgjithshme të subjekteve politike gjatë fushatës

## 7. Vëzhguesit e Zgjedhjeve

Zgjedhjet e 6 tetorit kanë zgjuar interes të madh në mesin e vëzhguesve të zgjedhjeve. KQZ-ja ka caktuar afatet për dorëzimin e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve, të cilëve iu është lejuar qasja në hapësirat për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Për vëzhgues nga subjektet politike dhe OJQ-të, afati i aplikimit për akreditim ka qenë prej 27 gusht deri më 27 shtator 2019. Ndërsa për vëzhguesit nga organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatat ndërkombëtare, mediat si dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, afati i aplikimit për akreditim ka qenë nga 27 gusht deri më 1 tetor 2019.

Për vëzhgimin e zgjedhjeve, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim kishte rekomanduar për akreditimin e 34,596 vëzhguesve, të cilët ishin akredituar në grupe të ndryshme. Numri kaq i madh i vëzhguesve, i bën zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit ndër zgjedhjet më të vëzhguara në Kosovë. Për vëzhgimin e zgjedhjeve janë akredituar vëzhgues nga pesë ambasada, një konsullatë, gjashtë organizata ndërkombëtare, 29 organizata vendore, 22 subjekte politike, si dhe rreth 60 medime vendore dhe ndërkombëtare. Pjesa më e madhe e numrit të përgjithshëm të vëzhguesve, gjegjësisht rreth 25 mijë sosh, ishin vëzhgues të subjekteve politike. Në kuadër të numrit të vëzhguesve nga subjektet politike, PDK-ja prin me numrin më të madh të vëzhguesve (5,991), pasuar nga LDK (5,729), NISMA-AKR-PD (5,281), AAK-PSD (5,136) dhe LVV (4,979). Gjithashtu, me ftesë të Presidentit të Kosovës, BE-ja ka dërguar në Kosovë një mision për vëzhgimin e zgjedhjeve (EU EOM), të cilët në ditën e zgjedhjeve kanë qenë prezent me 108 vëzhgues në nivel vendi.

Për këto zgjedhje, Demokracia në Veprim (DnV) ka pasur të akredituar gjithsej 3,113 vëzhgues, duke qenë kështu misioni më i madh i vëzhgues në vend, pa përfshirë subjektet politike. DnV ka pasur rreth 10% të numrit të përgjithshëm të vëzhguesve.

## 8. Dita e zgjedhjeve

Në ditën e zgjedhjeve, DnV-ja ka qenë e pranishme në të gjitha vendvotimet në Kosovë. Sipas raportimeve të regjistruara nga vëzhguesit tanë, në përgjithësi, procesi i votimit ka shkuar në mënyrë të rregullt dhe pa incidente serioze që do të minonin integritetin e zgjedhjeve. Sidoqoftë, dita e zgjedhjeve, ngjashëm si të proceset e kaluara zgjedhore, është shoqëruar me parregullsi të ndryshme, që janë evidentuar dhe raportuar nga vëzhguesit e DnV-së.

Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar për 63 raste ku është hasur **prani e materialeve propaganduese** brenda perimetrit prej 100 metra nga Qendra e Votimit, apo në 7% të Qendrave të Votimit. Rreth 30% e Qendrave të Votimit nuk kanë pasur qasje për personat me aftësi të kufizuara, duke kufizuar kështu për ta ushtrimin e të drejtës së votës.

**Gjatë hapjes së vendvotimeve** janë evidentuar probleme minore. Gjithsej, 2.3% e vendvotimeve janë hapur me vonesë, apo 60 vendvotime në total. Kjo shifër është dukshëm më e ulët në krahasim me zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, ku vonesa në hapje të vendvotimeve ishin regjistruar në 13.3% të tyre. Vonesat kryesisht kanë qenë disa-minutëshe dhe kanë qenë të natyrës teknike. Në disa raste ka pasur mungesa të pajisjeve dhe materialeve të nevojshme siç janë: spreji, vula, vonesat e komisionerëve, vonesa këto që nuk e kanë dëmtuar mbarëvajtjen e procesit të votimit.

**Procedurat e votimit** të cilat duhet të zbatohen gjatë ditës së zgjedhjeve përfshijnë kontrollimin me llamba ultra-vjollcë për të verifikuar nëse një votues ka votuar paraprakisht, identifikimin e votuesve në listën e votuesve përmes dokumenteve të identifikimit, spërkatjen me sprej të gishtërinjve të votuesve, si dhe vulosjen e fletëvotimeve për të vërtetuar origjinalitetin e fletëvotimit. Gjatë procesit të votimit, kryesisht janë respektuar procedurat e parapara ligjore.


Një nga rastet që ka marrë vëmendje të veçantë është **identifikimi i votuesve** me dokumente të vlefshme, por me afat të skaduar. Ky fenomen është evidentuar në 317 raste të ndryshme në nivel vendi. Mungesa e një udhëzimi të qartë nga ana e KQZ-së lidhur me këtë çështje, ka bërë që në disa komuna të lejohet një praktikë e tillë, ndërsa në komuna tjera jo.

**Asistimi i votuesve** të cilët kanë nevojë për ndihmë është i lejuar, por që nuk mund të bëhet nga i njëjti person më shumë se një herë. Personi i cili asiston një person tjetër duhet të regjistrohet në Librin e Votimit. Ofrimi i asistencës

nga ana e anëtarëve të KVV-së, duke përfshirë edhe vëzhguesit, nuk është i lejuar.

Vëzhguesit e DnV gjatë ditës së zgjedhjeve kanë evidentuar 42,571 raste të rregullta të asistimit të votuesve. Komuna me numrin më të madh të rasteve të votuesve me asistencë është Prizreni, me mbi 3 mijë votues të raportuar si votues me asistencë. Ka një trend të rritjes së numrit të rasteve të asistencës së votuesve krahasuar me zgjedhjet e parlamentare të vitit 2017 ku ishin evidentuar 31,477 raste të asistencës së votuesve.

### Numri i votuesve me asistencë (sipas komunave)



**Figura 3:** Komunat me numrin më të madh të votuesve me asistencë

Në këto zgjedhje, janë evidentuar gjithsej 542 raste kur një person ka **asistuar më shumë se një herë**. Këto raste janë evidentuar në 120 vendvotime në të gjithë vendin. Krahasuar me zgjedhjet e vitit 2017, është shënuar një rritje e rasteve të asistimit të votuesve në mënyrë jo të rregullt, kur ky numër e kishte arritur shifrën 424 sosh. Po ashtu, vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar për 169 raste tjera kur **anëtarët e KVV-së kanë ofruar asistencë** për votuesit. Kjo parregullsi është evidentuar në 84 vendvotime.

Fenomeni i **fotografimit të fletëvotimit** është njëra prej dukurive negative e cila i përcjellë proceset zgjedhore në Kosovë. Në zgjedhjet e 6 tetorit, ky fenomen është evidentuar në 113 vendvotime të ndryshme, me gjithsej 189 raste në nivel



vendi. Në vitin 2017, ky fenomen kishte arritur numrin prej 166 rasteve të evidentuara të fotografimit të fletëvotimit.

Mirëpo, ka raste kur edhe policia ka nisur hetime për këtë fenomen në lokacione të ndryshme. Fotografimi i fletëvotimit me qëllim të marrjes së rryshfetit është vepër e sanksionuar në bazë të nenit 215 të *Kodit Penal* të Republikës së Kosovës. Komunitet me më së shumti raste të evidentuara me fotografim të fletëvotimit janë: Komuna e Prishtinës që prin me 29 raste të evidentuara, e pasuar nga Peja me 21 raste, Ferizaj me 15, Prizreni me 14, Rahoveci me 12, Gjakova me 10, si dhe Deçani me Kamenicën me nga 8 raste secila. Ndërsa komunitet ku nuk është raportuar ndonjë rast të evidentuar të fotografimit të fletëvotimit janë: Dragashi, Kaçaniku, Fushë Kosova, Leposaviqi, Novobërda, Shtërpca, Zubin Potoku, Zveçani dhe Juniku.

## Rasted e fotografimit të fletëvotimit (sipas komunave)



**Figura 4:** Rasted e evidentuara të fotografimit të votës nëpër komuna

**Qëndrimi i më shumë se një personi prapa kabinës së votimit** është i ndaluar, për shkak se cenon fshehtësinë e votimit. Në këto zgjedhje, kjo parregullsi është evidentuar në 126 vendvotime, ku janë hasur 316 raste të qëndrimit të më shumë se një personi prapa kabinave të votimit. Nëse këtë numër e përkthejmë në përqindje atëherë kemi rreth 5% të vendvotimeve ku është evidentuar kjo parregullsi.

Fshehtësia e votimit cenohet edhe në momentin që ka raste të **votimit jashtë kabinave të votimit**. Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar për gjithsej 16 raste të tilla, të hasura në 15 vendvotime të ndryshme në nivel vendi. Kjo parregullsi ka shënuar rënie të ndjeshme në numrin e vendvotimeve ku është hasur kjo parregullsi, krahasuar me zgjedhjet paraprake të vitit 2017, kur ishin evidentuar 48 vendvotime ku ka pasur votim jashtë kabinave të votimit. Sa i përket rasteve

të **publikimit të fletëvotimit nga votuesit**, vëzhguesit kanë raportuar se kjo parregullsi është shfaqur në 76 raste, gjegjësisht në 61 vendvotime në nivel vendi.

**Pasaktësia e Listës Përfundimtare të Votuesve**, respektivisht pamundësia e votuesve për të gjetur emrin e tyre në LPV është një tjetër parregullsi që ka shoqëruar në vazhdimësi proceset zgjedhore në Kosovë. Në këto zgjedhje, janë evidentuar 17,382 raste kur votuesit nuk kanë gjetur emrin e tyre në LPV. Prej tyre, 2,158 apo mbi 12% e numrit të përgjithshëm të votuesve, janë hasur vetëm në vendvotimet në komunën e Prishtinës.

Ndonëse legjislacioni zgjedhor parasheh që vetëm trupat përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve, vëzhguesit dhe qytetarët me qëllim për të votuar mund të jenë të pranishëm në vendvotim, **prania e persona të paautorizuar** është raportuar në 28 vendvotime. Krahasuar me zgjedhjet e kaluara, kur ishin evidentuar vetëm 25 raste të tilla, mund të konkludohet se është shënuar përmirësim i lehtë në këtë drejtim.

**Incidentet në vendvotime** përgjatë procesit zgjedhor janë fenomene shqetësuese, të cilat kanë shënuar rritje krahasuar me zgjedhjet e kaluar. Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar se në 52 vendvotime ka pasur raste të incidenteve, për dallim nga zgjedhjet e vitit 2017, kur ishin evidentuar përgjysmë më pak raste. Në incidentet të cilat kanë qenë më serioze, ka pasur intervenim të menjëhershëm nga prokuroria dhe policia e cila i ka trajtuar me profesionalizëm.

Në zgjedhjet e 6 tetorit votues të regjistruar ishin gjithsej 1,961,213, ndërsa të drejtën e votës e shfrytëzuan 877,106 qytetarë ose thënë në përqindje 44.72%. Numri i përgjithshëm i vendvotimeve në tërë territorin e Republikës së Kosovës ishte 2,547, të vendosura në gjithsej 895 Qendra të Votimit.

Edhe në këto zgjedhje ka pasur numër të konsiderueshëm të qytetarëve që kanë ushtruar të drejtën e votës nëpërmjet **votimit me kusht**. Këtë formë alternative të votimit e kanë ushtruar gjithsej 26,825 votues në nivel vendi. Komuna me numrin më të madh të votuesve me kusht është Prishtina me 5,517 votues, apo rreth 20% e numrit të përgjithshëm të votuesve me kusht. Nga numri i përgjithshëm i votuesve me kusht, janë gjithsej 25,461 fletëvotime të vlefshme, 643 të pavlefshme (2.40%) dhe 529 të zbrazëta (1.97%).

Sa i përket **procedurave të numërimit**, shumica dërmuese e vendvotimeve janë mbyllur relativisht në kohë, me vonesa të vogla të cilat janë evidentuar për shkak se ka pasur ende qytetarë në pritje për të votuar. Nga vëzhguesit e DnV

janë evidentuar vetëm 57 raste, në të cilat vendvotimet janë mbyllur me vonesë. Gjithashtu, procesi i numërimit ka filluar me vonesë në vetëm 64 vendvotime, përkatësisht deri pas orës 20:00.

Një numër i konsiderueshëm i parregullsive lidhur me rezultatin zgjedhor u vu në pah pas përmbylljes së procesit të votimit. Pothuajse të gjitha këto parregullsi kanë ardhur si rezultat i lëshimeve të bëra nga ana e anëtarëve të KVV, të cilët në raste të caktuara kanë shënuar gabimisht të rezultatet në FPR. Megjithatë, nuk janë përjashtuar edhe rastet kur ka pasur tentativa të qëllimshme të komisionerëve për deformimin e rezultatit zgjedhor, të cilat janë evidentuar gjatë procesimit të rezultateve në sistemin e të dhënave në QNR. Procedura e rinumërimit shkaktoi vonesë të madhe në shpalljen dhe certifikimin e rezultatit përfundimtar zgjedhor nga KQZ-ja, e cila certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve më 27 nëntor, rreth dy muaj pas mbajtjes së tyre.

## 9. Drejtësia Zgjedhore

Subjektet politike duhet të sillen karshi rregullave të përcaktuara me ligj gjatë gjithë procesit zgjedhor.<sup>24</sup> Për tu siguruar që procesi zgjedhor zhvillohet brenda standardeve vendore, ligji mundëson raportimin e rasteve të shkeljes së rregullave dhe kodit të etikës nga subjektet politike tek Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. PZAP është institucion i pavarur dhe i përhershëm, përgjegjës për të vendosur për ankesat dhe apelet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Kryetari i Gjykatës Supreme emëron pesë anëtarët e PZAP-së nga mesi i gjykatësve të Gjykatës Supreme dhe gjykatave të qarkut.

Sipas dispozitave ligjore, të drejtë për të paraqitur ankesë në PZAP ka çdo person i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, apo i është shkelur e drejta e tij/saj gjatë procesit zgjedhor, ose është bërë shkelje e rregullave të përcaktuara me ligj. Në mënyrë që ankesa të jetë e plotë dhe të shqyrtohet nga PZAP, ajo duhet të ketë të bashkëngjitur me fakte konkrete për shkeljen e aluduar, përndryshe ankesa refuzohet. Gjithashtu, përmes ligjit rregullohen edhe afatet kohore të paraqitjes së ankesave dhe të shqyrtimit të tyre. Vlen të theksohet se ankesat e pranuar pas afateve kohore nuk shqyrtohen nga PZAP.

---

<sup>24</sup> Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, *Gazeta Zyrtare*, 15 qershor 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

E drejta për të paraqitur ankesë apo apel edhe para se të fillojë zyrtarisht fushata zgjedhore, është shfrytëzuar nga një numër i konsiderueshëm i palëve të përfshira në proces. Nga të dhënat e marra nga PZAP, ende pa filluar fushata zgjedhore janë pranuar 86 apele dhe tre ankesa nga individët, subjektet politike, dhe organizata të përfshira në procesin zgjedhor të zgjedhjeve të 6 tetorit. Pas shqyrtimit të tyre, PZAP ka vendosur që 12 apele t'i pranojë si të bazuara, 71 i ka refuzuar, katër i ka vlerësuar si të palejuara, ndërsa dy të tjera janë tërhequr nga vetë paraqitësit, derisa të gjitha kërkesat për këtë fazë i ka refuzuar.

Pas fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore, PZAP ka pranuar 140 ankesa të natyrave të ndryshme nga organizata joqeveritare, subjekte politike, ndërmarrje biznesi, policia e Kosovës dhe të tjera. Me tu shqyrtuar këto ankesa, PZAP vendosi që 81 prej tyre t'i pranojë si të bazuara, 52 i ka refuzuar si të pabaza, tre i ka hedhur si të palejuara, ndërsa katër të tjera janë tërhequr nga paraqitësit.

Numër të madh të ankesave ka pasur edhe lidhur me heshtjen zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve, ku janë paraqitur gjithsej 104 ankesa. PZAP i ka pranuar si të bazuara 32 prej tyre, 65 ankesa i ka refuzuar si të pabazuara, ndërsa shtatë të tjera i ka hedhur poshtë. Krahas shqyrtimit të tyre, PZAP ka shqiptuar edhe gjoba të konsiderueshme ndaj individëve apo subjekteve politike që kanë shkelur Kodin e Mirësjelljes gjatë fushatës zgjedhore apo kanë thyer heshtjen zgjedhore. Shuma e përgjithshme e gjobave të shqiptuara nga PZAP është 360 mijë euro. Prej tyre, subjekti politik me shumën më të madhe të gjobave të shqiptuara ndaj tij është PDK, me gjithsej 100,100 euro gjoba.

	Shuma e gjobave
Partia Demokratike e Kosovës – PDK	€ 100,100.0
AAK-PSD – Koalicioni 100% Kosovë	€ 89,600.0
Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK	€ 74,850.0
Srpska Lista	€ 36,500.0
NISMA - AKR - PD	€ 33,900.0
Lëvizja VETËVENDOSJE!	€ 14,100.0
”SLOBODA”	€ 5,100.0
Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës – IRDK / Lendrit Qeli	€ 1,200.0
Kosova Demokratik Türk Partisi – KDTP	€ 1,100.0
Pokret za Gora – PG	€ 1,100.0
Partia Liberale Egjiptiane - PLE	€ 1,100.0
Koalicija VAKAT	€ 1,100.0
Partia Rome e Bashkuar e Kosovës – PREBK	€ 250.0
<b>Gjithsej</b>	<b>€ 360,000.0</b>

**Tabela 3:** Gjobat e shqiptuara për shkak të shkeljeve lidhur me fushatën dhe heshtjen zgjedhore, sipas subjekteve politike

Përderisa natyra e ankesave dhe apeleve deri në ditën e zgjedhjeve ka pasur të bënte më shumë me listat e votuesve brenda dhe jashtë vendit, kandidatëve nëpër lista të subjekteve politike, apo edhe të vendosjes së materialeve propaganduese nëpër hapësira publike, që nga 7 tetori, pjesa më e madhe e tyre ka qenë mbi gabimet e bëra gjatë numërimit të votave nëpër vendvotime dhe QNR, kërkesa për rinumërim të vendvotimeve, si dhe kërkesa që të numërohen votat e ardhura nga jashtë Kosovës për të cilat është diskutuar gjerë e gjatë nëse duhet të pranohen si të vlefshme apo jo për shkak se kanë arritur me vonesë në KQZ për shkak se janë dërguar me postë.

Mes periudhës 7 tetor dhe 31 nëntor 2019, në PZAP janë paraqitur gjithsej 183 ankesa dhe apele në lidhje me procesin zgjedhor. Pas shqyrtimit të tyre nga anëtarët e PZAP, 67 prej tyre janë pranuar si plotësisht të bazuara dhe 2 si pjesërisht të bazuara, ku si rrjedhojë ka ardhur vendimi i PZAP për KQZ-në që të fus në rinumërim 1,472 vendvotimeve si dhe të largimin e votave të ardhura nga Serbia nga rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për kuvend të Kosovës të 6 tetorit 2019, ndërsa për pjesën e mbetur të ankesave dhe apeleve, 49 prej tyre janë refuzuar si të pabazuara, 62 janë hedhur poshtë, një ka mbetur ende në procedurë, ndërsa dy prej tyre janë tërhequr nga paraqitësit e kërkesës.

Në anën tjetër, kërkesa e paraqitur nga koalicioni NISMA-AKR-PD që të mos numërohen dhe përfshihen 4,639 votat nga jashtë të ardhura me vonesë përmes postës është refuzuar nga PZAP. Si rrjedhojë, të njëjtën kërkesë ky koalicion e ka paraqitur në Gjykatën Supreme, mirëpo as aty nuk morën përgjigje pozitive, pasi që kjo gjykatë vendosi që këto vota të numërohen nga KQZ dhe të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

Për këtë çështje, koalicioni NISMA-AKR-PD iu drejtua edhe Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar nga ajo anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme dhe eliminimin e jo-kushtetutshmërisë së supozuar.<sup>25</sup> Po ashtu, ky subjekt kishte kërkuar nga Gjykata Kushtetuese edhe vendosjen e masës së përkohshme për ndalimin e certifikimin e rezultatit të zgjedhjeve, deri në një vendim përfundimtar për çështjen kontestuese. Gjykata Kushtetuese ende nuk ka nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën e paraqitur nga koalicioni NISMA-AKR-PD.

---

<sup>25</sup> Lajmi.net, 22 nëntor 2019, <https://lajmi.net/nisma-akr-pd-ankohen-ne-kushtetuese-per-votat-e-ardhura-me-vonese-nga-diaspora/>

## 10. Rekomandimet

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti, si dhe zhvillimeve të përgjithshme lidhur me procesin zgjedhor, Demokracia në Veprim ofron një sërë rekomandimesh të cilat synojnë përmirësimin e procesit zgjedhore në përgjithësi. Këto rekomandime, duhet të jenë pjesë e **reformës zgjedhore**, për të cilën DnV-ja vlerëson që duhet të jetë një nga prioritetet kryesore të qeverisjes së ardhshme, duke u bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe transparencës.

Rekomandimet e poshtëshënuara, duhet të adresohen nga akterë të ndryshëm, duke filluar nga ligjvënësit, trupat përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, subjektet politike dhe kandidatët e tyre, institucionet përkatëse të sigurisë dhe drejtësisë, shoqëria civile, si dhe institucionet tjera në fushëveprimin e të cilave bie përgjegjësia për ndonjë prej operacioneve zgjedhore.

Fillimisht, duke qenë se të gjitha zgjedhjet parlamentare që janë mbajtur pas shpalljes së pavarësisë kanë qenë të parakohshme, institucionet përgjegjëse për organizimin dhe menaxhimin e zgjedhjeve kanë hasur në vështirësi për administrimin e operacioneve zgjedhore. Afatet e shkurtra kohore kanë ndikuar shpesh edhe në pamundësimin e zhvillimit të mirëfilltë të aktiviteteve të parapara zgjedhore, apo dështimin e tyre.

Për këto arsye, DnV-ja vlerëson që bazuar edhe në praktikat e mira ndërkombëtare, afati kohor brenda së cilit duhet të mbahen zgjedhjet pas shpalljes së tyre nga ana e Presidentit, duhet të jetë minimalisht 45 ditë, por jo më shumë se 60 ditë.

### 10.1. Dita e zgjedhjeve dhe kapacitetet e trupave menaxhuese të zgjedhjeve

Duke qenë një prej proceseve më të ndjeshme dhe problematike të këtyre zgjedhjeve, numërimi i votave duhet t'i nënshtrohet një analize dhe debati përmbajtësor.

KQZ-ja duhet të zhvillojë trajnime dhe testime më rigorozë për anëtarët e KVV-ve, para se të njëjtit të caktohen në vendvotime, në mënyrë që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të kryhen me profesionalizëm. Prioritet duhet të kenë shkeljet më të shpeshta, të tilla si abuzimi me votimin me asistencë, votimit të dyfishtë, fotografimit të votës, cenimit të fshehtësisë së votimit dhe të ngjajshme.



Në këtë drejtim, edhe subjektet politike duhet të nominojnë komisionerë me integritet dhe përgatitje të duhur profesionale.

Subjektet politike duhet që minimalisht të respektojnë Deklaratën e nënshkruar nga to në vitin 2015, që siguron pjesëmarrje të grave në trupa menaxhuese të zgjedhjeve prej të paktën 40%. Në të ardhmen duhet të shtohen përpjekjet për garantimin e përfaqësimit të barabartë gjinor 50-50 në trupat menaxhuese të zgjedhjeve.

Pas përfundimit të zgjedhjeve, Librat e Votimeve, që janë të vendosura në secilin vendvotim, duhet të jenë objekt i auditimit nga KQZ-ja, në mënyrë që të evidentohen dhe trajtohen detajisht parregullsitë që janë hasur gjatë ditës së zgjedhjeve.

Personave me aftësi të kufizuara duhet t'iu ofrohet qasje adekuate në secilin vendvotim dhe në format e qasshme të votimit për grupet përkatëse.

## **10.2. Votimi jashtë vendit**

Duke marrë parasysh numrin e rritur të votuesve jashtë vendit, si dhe problemet e shpërfaqura gjatë këtyre zgjedhjeve me këtë operacion, nëpërmjet reformës zgjedhore duhet të rishikohet në tërësi procedura e votimit jashtë vendit. Duhet të përcaktohen qartazi procedurat për regjistrimin e votuesve jashtë vendit, dërgimin, pranimin dhe numërimin e votave të ardhura nga jashtë, duke përfshirë edhe natyrën e pavlefshmërisë eventuale të këtyre votave. Ndryshimet normative eventuale duhet të mënjanojnë çfarëdo hapësire për interpretim ambiguitiv të dispozitave përkatëse.

Me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së integritetit të këtij procesi, duhet të shtohet mekanizma të sigurisë në kuadër të këtij operacioni, të cilët garantojnë parimet themelore të votimit, të tilla si vota e lirë dhe fshehtësia e votës.

Qytetarëve dhe palëve tjera duhet t'iu ofrohet më shumë kohë për sfidimin dhe kontestimit të Listës së Votuesve Jashtë Vendit, në mënyrë që të evitohen manipulimet e ndryshme që mund të bëhen në emër të votuesve.

## **10.3. Informimi i votuesve**

Edhe pse është shënuar rënie në përqindjen e fletëvotimeve të pavlefshme në këto zgjedhje, duhet të vazhdohet me përpjekje për uljen e mëtutjeshme të tyre. Duke qenë se dizajni i fletëvotimit ka rol të madh në evitimin e mundësisë së gabimeve nga votuesit, KDI ka propozuar një dizajn të ri të testuar me qytetarë, andaj i njëjti duhet të merret parasysh dhe të përdoret në ciklet e ardhshme zgjedhore nga KQZ-ja.

Fushatat për informimin dhe edukimin e votuesve duhet të jenë të vazhdueshme dhe jo vetëm gjatë periudhave të zgjedhjeve. Targetet primare të këtyre kampanjave informuese duhet të përcaktohen mbi bazën e analizave të cilat evidentojnë zonat dhe grupet demografike që kanë më shumë nevojë për informim dhe edukim.

Cilësia e produkteve të fushatës për informim të KQZ-së, duhet të përmirësohet ndjeshëm, si në aspektin vizuel, ashtu edhe në atë përmbajtësor. Produktet duhet t'i përshtaten mjeteve të komunikimit ku ato plasohen.

#### **10.4. Fushata**

Subjektet politike në pushtet duhet t'i përmbahen dispozitave ligjore lidhur me përdorimin e resurseve publike në fushatë, veprime këto të cilat janë rreptësisht të ndaluara. Përfshirja e fëmijëve dhe shërbyesve publik në aktivitete të fushatës për qëllime elektorale duhet të ndërpritet si praktikë e subjekteve politike.

Zhvillimi i aktiviteteve elektorale nga subjektet politike para fillimit zyrtar të fushatës, duhet të rregullohet me ligj. Rrjedhimisht, edhe shpenzimet e bëra nga subjektet politike dhe kandidatët të tyre gjatë kësaj periudhe duhet të jenë pjesë integrale e kufizimit të shpenzimeve, i cili caktohet nga KQZ-ja.

Personave me aftësi të kufizuara duhet t'iu ofrohet qasje adekuate fizike në secilin aktivitetet të organizuar gjatë periudhës së fushatës.

#### **10.5. Financimi i subjekteve politike gjatë fushatës**

Financimi i subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës duhet të jetë më transparent, duke i ofruar qasje 'online' të gjithë qytetarëve dhe palëve të interesuara. Subjektet politike dhe kandidatët e tyre duhet t'i përmbahen në mënyrë strikte kufizimeve të KQZ-së për shpenzimet gjatë fushatës.

Reforma zgjedhore duhet patjetër të rregullojë çështjen e deklarimit financiar për kandidatët e subjekteve politike, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet personale për periudhën gjatë fushatës.

Subjektet politike duhet të hapin llogari të veçanta bankare për financimin dhe shpenzimet e tyre gjatë fushatës, të cilat duhet të jenë transparente dhe të qasshme për publikun, në faqen elektronike të KQZ-së, ndonjë portal tjetër, ose në faqet elektronike të vetë subjektit politik apo kandidatëve.

Auditimi i financave dhe shpenzimeve të fushatës së subjekteve politike duhet të përmbyllet brenda afateve të parapara ligjore.

## **10.6. Lista e votuesve**

Nevojitet përcaktim i qartë ligjor lidhur me dokumentet e vlefshme që mund të përdoren për votim. Votimi me dokumente me afat të skaduar duhet të sanksionohet ligjërisht.

Pasaktësia e listës së votuesve mbetet një nga shqetësimet më akute të proceseve zgjedhore. Heqja e personave të vdekur nga lista e votuesve kërkon përkushtim më të madh institucional. Institucionet mund të shohin edhe për mundësinë e regjistrimit aktiv të votuesve. Përpjekjet për përfundimin e krijimit të sistemit të unifikuar dhe të integruar të adresave duhet të intensifikohen.

Institucionet përkatëse duhet të shohin mundësinë për përdorimin e metodave inovative për informimin e qytetarëve për Qendrën e Votimit dhe vendvotimin ku ata mund të ushtrjnë të drejtën e votës.

## **10.7. Përfaqësimi gjinor në listat e kandidatëve**

Listat zgjedhore të subjekteve politike duhet të reflektojnë përfaqësim të barabartë gjinor, duke përdorur modelin 'zebra' - duke garantuar që çdo i dyti kandidat të jetë i gjinisë tjetër.

## **10.8. Harmonizimi i kornizës ligjore**

Legjislacioni primar zgjedhor duhet të harmonizohet në funksion të përfshirjes së çështjeve të cilat aktualisht rregullohen vetëm përmes rregullave zgjedhore të miratuara nga KQZ-ja, të cilat përveçse dalin përtej ligjit, nuk e kanë as fuqinë e njëjtë juridike.

## **10.9. Drejtësia zgjedhore**

Organet e ndjekjes duhet të trajtojnë me prioritet rastet kur komisionerët kanë tentuar apo kanë deformuar vullnetin zgjedhor të qytetarëve. Për më tepër, organet duhet të aplikojnë sanksionet maksimale për rastet në fjalë.

## 11. Shtojca

### 11.1. Rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve dhe ndarja e ulëseve sipas subjekteve politike

	Nr. i votave	%	Nr. i ulëseve
LVV	221,001	26.27 %	29
LDK	206,516	24.55 %	28
PDK	178,637	21.23 %	24
AAK-PSD	96,872	11.52 %	13
Lista Serbe	53,861	6.40 %	10
NISMA – AKR – PD	42,083	5.00 %	6
Koalicija VAKAT	7,075	0.84 %	2
KDTP	6,788	0.81 %	2
PLE	4,887	0.58 %	1
NDS	3,935	0.47 %	1
PAI	3,113	0.37 %	1
Fjala	2,852	0.34 %	0
PDAK	1,963	0.23 %	0
SLS	1,859	0.22 %	0
IRDK	1,755	0.21 %	1
PEK	1,173	0.14 %	0
JGP	1,159	0.14 %	1
PreBK	1,078	0.13 %	1
SDA	834	0.10 %	0
PKS	816	0.10 %	0
GIG	785	0.09 %	0
PG	695	0.08 %	0
“Sloboda”	672	0.08 %	0
Esmir Kasi	577	0.07 %	0
KNRP	289	0.03 %	0







## PËRKRAHUR NGA:

